

# KOSOVARJA

Ballina: Donjeta Kosumi

**Babai i 26  
fëmijëve**

**Plaku i  
Lismirit fle  
me gjarpinj  
në gji**

**Vajzat i  
falë Zoti  
e i merr  
dreqi**

**Visar Sinani  
imazh i  
mashkullit  
ideal**

**Këngëtarët  
tanë  
me tekste  
skandaloze**

**Gruaja  
nuk do divorc,  
dashnorja nuk  
po më hiqet**

**Sa herë  
në javë  
bëjnë seks  
shqiptarët**

*Kallashi*  
*historinë e bën vetë*

**remos**

**eurokoha**

**SHERWOOD**

**MARITIM**

**CIMA**

**UB**  
UNION BUSINESS  
ALBANISCH & DEUTSCH

**DINO**  
CERAMICHE

**Shkabaj**

**MOLLA**

**Shkenda Dyben**

**iAs**

**DENTFIX**

**allure**





# DINO COMPANY

MAGJISTRALJA PRISHTINE-FERIZAJ km-2, 14000 LIPJAN, KOSOVË

+383 44 206 586  
www.dino-company.com

Dino keramika, është kompani e cila ofron produkte me shumice dhe pakicë, nje game të gjere të llojeve të keramikës të cilat vijnë nga fabrikat me të njohura italiane dhe spanjolle ; "mirage", "azuvi", "ecoceramic"

Strukturë dhe ngjyrë të veçantë, efekte që kënaq shijet dhe nevojat estetike, kombinime të koordinuara, kontraste dhe përshtatje.



NUK LËSHOJNË  
KOMPONENTE  
TË DËMSHME

ARMIQ  
NDAJ  
BAKTERIEVE

NUK  
PËRBEJNË  
ALERGJI

PASTROHEN  
LEHTË

NUK LËSHOJNË  
KOMPONENTE  
TË DËMSHME



info@brezovicahotel.com  
www.brezovicahotel.com





# Ku, si, çka... Ku, si, çka...



## FIFI

Fifi, pa dyshim, është një nga këngëtalet më në zë shqiptare që gjithmonë di të vjedhë zemrat e publikut, sidomos me baladat e saj të famshme.

Mirëpo, ndër të tjerash, Fifi është komentuar edhe për format e saj trupore, për të cilat nuk ka pasur kurrë komplekse të flasë hapur dhe të përcjellë mesazhe mjaft domethënëse.

Ajo është komentuar shumë në media edhe për rrugën e gjatë të ndryshimit, pasi vendosi të humbasë disa kilogramë dhe kjo për shkak të shëndetit.

## BESNIK KRAJKU

Besnik Krajku është këngëtar i njohur, sidomos i periudhës së viteve 70-80. Por, ai nuk i nda këngës edhe në vitet tjera të jetës.

Mori pjesë në të gjitha festivalet e kohës, sidomos në "Akordet e Kosovës", në "Zambaku i Prizrenit" etj. dhe është laureat i shumë çmimeve.

E veçuan shumë këngë, por njëra ishte e veçantë. Bëhet fjalë për këngën me titull "Këngë moj buçit në male", këngë që u dëgjua dhe u mësua përmendësh nga shumë adhurues të tij të shumtë...

Në qershor 2007, Besnik Krajku merr pjesë në "Polifest 2007", me këngën "Pa ty". Në mars 2014 merr pjesë në "Kënga ime 2014", me këngën "Këngë Moj" etj. Po atë vit merr pjesë në "Kënga ime 2014" me këngën "Nostalgji" etj.

Besnik Krajku një kohë u përfshijë edhe në politikë...



## ROBERT BOJA

Është njëri ndër gazetarët që punon shumë. Por, shumë pak, për të mos thënë fare, shkruhet për të!

Ka filluar karrierën në RTV21, kurse tash është pjesë e Televizionit ATV.

Emisioni i tij, "N'frekuencë me Robin", përcillet me shumë interesim. Se është kështu flet më së miri inkuadrimi në emision i shumë teleshikuesve, e që e bën shumë interesant emisionin e tij.





*Kallashi, e bukura e dheut, që nuk ndalet së befasuari fansat e saj të shumtë, të cilët e ndjekin në çdo hap, së fundi, ka goditur me foto të reja, ku hiret e saj vihen plotësisht në pah.*

# Kallashi *historinë e bën vetë*



## SHIJET E KALLASHIT

Donjeta Kosumi, që u bë Kallash, vajzë që tashmë e njohin pothuajse të gjithë, ka çka thotë, ka çka tregon... Ajo ka karrierë disavjeçare në fushën e vallëzimit dhe të muzikës dhe emri i saj u bë më i njohuri.

Ata që e njohin thonë se pas imazhit sensual, fshihet një femër e fortë e me ide të qarta, që di t'ia dalë në jetë. E ëmbël me ata që sillen mirë, që mundohen ta kuptojnë drejt, ndërkohë ndryshon për ata që e marrin për tjetër, që duan ta tregojnë siç nuk është. Donjeta apo Kallashi, kjo s'ka rëndësi, meqë të veçantë e bën karakteri dhe historia e saj, që nga fëmijëria e deri më tani...

## YLLI I VALLËZIMIT

Kallashi është qind për qind zeshkane, atraktive dhe deri në pikë të fundit - e singertë.

E, këtë e ka treguar edhe nëpërmjet intervistave e rrëfimeve të saj publike. Dhe, sado që vitet ecin, ajo mbetet diva e vallëzimit, vajza që me një lëvizje bën që të gjithë të bien në dashuri me të. Për momentin jetën e saj e mbanë krejt private, saqë qasja duket tejet e vështirë. Sepse, Kallashi ia ka marrë dorën edhe kësaj pune, di se si duhet ruajtur atë që është vetëm e saj. Por, kureshtja për të ditur më shumë për të, gjithmonë mbetet e madhe...

## E NDJEKIN MIJËRA NJERËZ

Ajo e ushtron profesionin e saj, por nuk dihet kush e ka rrëmbyer zemrën e saj. Në faqen e saj në "Instagram", ndiqet nga mijëra njerëz, të cilët "ushqehen" me imazhin e femrës më shpërthyesë në Kosovë.

Dhe, sa herë që shfaqet, bën me mijëra adhurues të rinj...

Shkurt e shqip: Kjo është Donjeta Kosumi (Kallashi), femër shumë e veçantë, e që historinë e bën vetë...

**N.N.**





Në prag të zgjedhjeve lokale në Kosovë...

# Ai politikan që flet për dashuri ka me u bë kryetar komune!

*Filmat orientalë shikohen në Kosovë me të madhe dhe televizionet e kanë gjetur veten në këtë “mision” shikueshmërie. Po të mos ishin filmat e tillë, televizionet tona nuk do të shikoheshin në masën sa shikohen tash.*

Gruaja ime i shikon serialet turke dhe një ditë, teksa e shikonte Miranin, në kohën kur luhej një ndeshje ndërkom-bëtare futbolli, bëmë poterë në salonin e shtëpisë.

“Ndërroje kanalin grua e qitma futbol-lin!”, i thashë.

“Le që je bërë dembel, por edhe nuk po sheh se jam kah e shikoj Miranin!”, ma ktheu ashpër.

“Ç’lidhje ka kjo?”, e pyeta unë.

“Është një ngjarje për dashuri dhe, normalisht, ka shumë lidhje. E, çka ka lidhje futbolli yt, ku çdo ditë shikon futbolli?! Të është mbushur koka vetëm futbolli!”

“Mirë e ke, sepse më për dashuri nuk flet askush, pos në serialet tua. Për dashuri, edhe atë për hajgare, ndon-jëherë flet vetëm ish-deputeti Milaim Zeka. Ai një ditë pat thënë se Amerika po t’i thotë mos fle me grua, do e dëg-jonte Amerikën”, i thashë gruas, e cila në ato çaste as që kishte qenë duke më dëgjuar.

## DO BËHET KRYETAR KOMUNE AI QË FLET PËR DASHURI!

Nejse, e nisëm me diçka tjetër dhe dola dikur tjetër... Prandaj, të kthe-hem përsëri te gruaja. Ajo filmin - unë futbollin! E mora televizorin nga dhoma tjetër dhe e vendosa pranë televizorit tjetër. Dy televizorë në një dhomë, madje mbi të njëjtën tavolinë... Unë futbollin ajo Miranin. “Uh, po kollaj paska qenë ta zgjidhim problemin!”, i them gruas, “Për pak s’u zëmë, e zënka kushedi çfarë do të kishte pasuar: shi, breshër a borë?!” i thashë.

“Edhe unë do t’i kisha dëgjuar politikanët tanë po të flisnin edhe për dashuri, e jo vetëm për sukseset e tyre, thuajse Kosova është bërë xhenet!”, më thotë ajo me zë të lartë. “Po, ama, si të flasin për dashuri ata, grua?!”, i them unë.

“Epo, tash që janë afër zgjedhjet lokale, nëse dëshiron të bëhet kryetar komune, politikanin duhet të flasë edhe për dashuri, jo vetëm për premtime politike, sepse për lavde më askush nuk po i dëgjon!”, më thotë ajo.

“Po flet kështu për politikanët tanë e vetë ua ke dhënë votën! E, tash çka po ndodh me ty?”, ia ktheva unë.

“Asgjë nuk po ndodh, por politikanët tanë janë rrasë deri në fyt në hajni! E, më nuk do i votoj! Dhe, pas të gjitha këtyre tollovive psikike, ku sheh gjë të mirë te ne?”, ma kthen me plot nervozë gruaja.

“Eh, duhet t’i kesh sytë e qeveritarëve, moj grua, për të parë gjëra të mira... Nuk mundet çdo kush të sheh mirë e bukur. Nuk është pranverë për çdo kënd, por vetëm për ata që dinë të dredhojnë”, ia ktheva me tallje, sepse e pash se gjërat po thellohen.

**S. Murturi**

Pronar dhe botues:  
Gani DILIRedaktor përgjegjës:  
Isa ILAZIMenaxher:  
Driton DILIRedaksia:  
Safet Krivaça (reporter i lirë)  
Nderim Neziri (redaktor)  
Besiana Dili  
Drenushë Haredinaj  
Rilinda Krasniqi  
Ardita Dili  
Flakë AjetiDizajni:  
Labinot BërbatovciAdresa e redaksisë:  
Fahu postal 18, 10000 Prishtinë  
Tel: 038 51 75 75  
Email: [info@kosovarja-ks.com](mailto:info@kosovarja-ks.com)Marketing:  
Tel: +383 44 143 448;  
Email: [marketing@kosovarja-ks.com](mailto:marketing@kosovarja-ks.com)


# KËNDON A VAJTON BILBILI?

*S'më kujtohet se kush ka thënë, por më kujtohet thënia:  
"Jeta është e bukur, por të ekzistuarit është i tmerrshëm!"*

Ende vazhdojmë të merremi e të humbim kohë pas disa gjërave: kam thënë, ke thënë...

Tash duhet të jetojmë me të sotmen, të cilën duhet ta bëjmë më të mirë, më të lumtur për secilin qytetar, se secili për ne kemi dhënë për këtë ditë...

Të mendojmë se shumë qytetarë në Kosovë janë në rrezik për jetë, shumë të tjerë në amulli për të ardhmen, e shumë e shumë të tjerë s'dinë ç'të bëjnë, sepse elita politike ka lënë pasoja nga korrupsioni, keqmenaxhimi, si dhe shumë gjëra të tjera, e kanë tepruar edhe me tërpinë e pushtetit apo tërpinë për pushtet dhe lakmi të tjera...

Duhet hequr qafesh këtë sindromë të etjes pas karriges, pas qejfeve, pas parasë, sepse nuk mund të jesh i pasur në mesin e të varfërve dhe britmave të tjera për jetë, ekzistencë.

Shumë ngjarje të së kaluarës sonë na mësojnë se si e sa duhet të jemi të vëmendshëm sot për të ardhmen.

Kosova mund të mposhtet po qe se do i mungojë "qëndresa e përbashkët". Konica, me të drejtë, shkruante dhe me dhimbje se "Tragjedia e shqiptarëve si komb fillon te kulti i tyre për heroizmin vetjak, duke mos vlerësuar

domosdonë në kohët moderne të heroizmit të bashkuar si një popull i vetëm".

Dhe, deri kur do të mendojmë dhe do të ve-projmë si të ishim disa popuj dhe t'i kishim disa çështje?! Ndoshta, pikërisht, në përgjigjen e kësaj gjendet edhe çelësi ynë i së ardhmes.

## NË SHËTITJE

Mëngjes i hershëm shtatori në Gërmi. Kënaqet shpirti dhe syri me pamjen që ka ky vend.

"Ja, të kënaqë cicërima e zogjve dhe bilbilave që këndojnë", më thotë miku, me të cilin ndër-rojmë ngadalë hapa për në Gërmi.

"Ku ta dimë ne: këndojnë apo vajtojnë bilbi-lat?!", i them mikut.

Vërtet, këndon apo vajton bilbili?

## E VOGLA ZEMËR, E SHKRETA ZEMËR...

E vogël është zemra. Nuk ka vend në zemër për dashuri dhe për urrejtje, se e vogël është zemra. Mund të hyjë në zemër dashuria e gjithë botës, ose urrejtja e gjithë botës. Por, të dyja nuk kanë vend në të njëjtën zemër.

**Gani DILI**





*Babai i 26 fëmijëve, Milaim Zogiani, nga fshati Harilaç, komuna e Fushë-Kosovës, tregon pse donte shumë fëmijë.*

*Ishte martuar me dashuri në vitin 1963. Dhe, pajtimi me miq ishte bërë me rastin e pritjes së mbesës nga dajallarët pas disa vitesh, kur edhe ndodhi pajtimi.*

*Milaimi ishte akuzuar nga pushteti i kohës pse kishte lindur 26 fëmijë. E quanin irredentist!*

*Specialitet të burrit me 26 fëmijë janë “çaji i rusit” dhe katër pako cigare në ditë.*

# Babai i 26 fëmijëve

Milaim Zogiani, në kohën kur e bëmë këtë bisedë, në vitin 2004, ishte 59-vjeçar. Është nga fshati Harilaç i Fushë-Kosovës, njëri nga baballarët që ka më së shumti fëmijë në Kosovë. I ka 26 fëmijë nga dy martesë, 6 me të parën dhe 20 me gruan e dytë, Dinoren.

Thotë se donte të ishte kampion i fëmijëve, por nuk arriti, sepse rekordin në Kosovë e mban dikush tjetër, i cili i ka 32 fëmijë, duke ia atribuar lavdin një burri nga fshati Shkabaj i Prishtinës. Njeriu që pi 80 gota “çaj rusi” në ditë dhe thith rreth 80 cigare dhe pi disa hapa “kafetin” në

ditë, duke përshkruar historinë e jetës së tij, thotë:

“Me gruan e parë i kisha 6 vajza. Me të dytën, Dinoren, i lindëm 20 fëmijë. E para i kishte 54 muaj shtatzëni, ndërkaq e dyta 180. Dhe, nëse i shndërrojmë muajt në vite, del se gruaja e parë i kishte 4 vite e 6 muaj shtatzëni, ndërsa e dyta 20 vite shtatzëni. Nëse llogaris çajat që pi gjatë një dite, atëherë del se gjatë një viti pi 28 mijë e 80 çaja dhe thithi rreth 43 mijë e 200 cigare. E, sa u përket “kafetinëve”, një mjek më ka thënë se po ta dinte prodhuesi, “Galenika”, sa hapa pi në ditë, do më shpërblente.



## KONKRETISHT, KUSH ËSHTË MILAIM ZOGIANI?

Milaim Zogiani, me profesion elektrikist i KEK-ut, baba i 26 fëmijëve, në historikun e jetës së tij kurrë nuk ka marrë shtesa për fëmijë.

Serbët e kishin quajtur irreden-tist, meqë ishte një "burim" i madh i lindjes së fëmijëve. Për ta bindur Milaimin se duhej të pushonte me natalitet, serbët i kishin thënë në punë dhe në fshat se lindja e tillë e fëmi-jëve i sjellë shtëpisë varfëri dhe jetë të ligë. Por, ky nuk përfillë "këshillat" serbe dhe nuk ka vit që nuk ka një a më shumë fëmijë.

Dëshira e tij më e madhja është po t'i kishte të gjithë gjallë, por... "I kam bërë me dëshirë, por shumë prej tyre m'i mori Zoti. Jam mërzhitur shumë për çdon-jërin që ka vdekur. Më kanë vdekur nga mosha 3 muajsh dhe një vit. Dhe, është e rëndë kur e humbë bimën e shpirtit... Çdonjërin që ka vdekur e kam hospitalizuar paraprakisht dhe i kam qëndruar te koka me të gjitha gjërat. Kam pasur shpenzime, por kurrë nuk më ka ngushtuar Zoti", tregon Milaimi, derisa vajza i sjellë çaj pa ndër-prerë, pa e pyetur do a s'do...

## U MARTUA ME DASHURI DHE BËRI BUJË MARTESA E TIJ...

Për martesën e parë, me bash-këshorten që pati 6 vajza dhe u martua në vitin 1963 me dashuri, e që ishte veçanti e kohës, thotë:  
"E mora me dashuri gruan e parë, edhe pse në vitin 1963, të bëhej diçka e tillë, ishte goxha e pazakonshme.

Kemi qenë në të njëjtën klasë. E grabita dhe e solla në shtëpi. Erdhën familja e saj dhe ma morën në besë, duke më prem-tuar se do ma jepnin me dëshirë, më vonë, për të ruajtur dinjitetin familjar.

U pajtova t'ua jepja, por ata nuk e mbajtën fjalën. Dhe, pas gjashtë muajsh, e grabita përsëri. Por, ata sërish nuk u pajtuan.

Kur u lind vajza e dytë, po i ndiqja mësimet në shkollën e mesme "Nikolla Teslla" në Obiliq dhe fati deshi që vëllai i bash-këshortes qëlloi në të njëjtën klasë me mua. Zëvendës drejtori i shkollës, Ismail Dumoshi, kishte dëgjuar për rastin tim dhe mori iniciativën e pajtimit tonë. Dhe, pas një viti u pajtuam... Jetova me të 13 vite dhe lindi 6 vajza. I thashë se tradita jonë është të kemi një djalë dhe rendi ishte ta merrja edhe një grua, ajo nuk pranoi. Dhe, kështu, erdhi te ndarja jonë, pavarësisht se ishim martuar me dashuri".

## GRUAJA E DYTË LINDI 20 FËMIJË!

Milaim Zogiani, pas ndarjes me bashkëshorten e parë, fatin e tij e gjeti në fshatin Divjakë, afër Kleçkës, komuna e Lipjanit.

"E mora gruan e dytë pa e parë fare dhe më dukej se nuk ishte asgjë në rregull, krahasuar me rastin e parë, kur e mora me "dashni", thotë Milaimi, duke përshkuar martesën e dytë. Ai pati fatin t'i lindte me të 20 fëmijë. Të gjithë fëmijët kanë lindur në shtëpi, pa shkuar te mjeku a në klinika.

Një vit pas martesës së dytë u lindi djali, Petriti, i cili vdes pas tre muajsh. I dyti, Kujtimi, u lind, gjithashtu, në krye të vitit tjetër dhe tash është 26 vjeç.

"Të gjithë kanë lindur në çdo vit. S'ka vit që nuk kam nga një fëmijë. Gruaja e dytë, Dinorja, ka kaluar mirë në të gjitha lindjet... Dhjetë fëmijë me Dinoren i kam gjallë. Janë pesë me pesë nga gjinia.

Nuk i mbaj mend të gjithë emrat e fëmijëve, andaj i kam shënuar në listë dhe listën e mbaj në xhep. Deri këtu fëmija më respektojnë dhe më përfillin shumë. E kisha vështirë t'i rrisja me një rrogë të KEK-ut, por Zoti ma solli idaren. Nuk jam dalluar shumë ekonomikisht nga fqinjët e mi, edhe fëmijët kishin shpenzime... Qëllimi im ka qenë të kem shumë fëmijë. E kam ditur se po të kem shumë fëmijë, do të rritet numri i banorëve të Kosovës. Kam thënë se nga shumica nuk ka asgjë të keqe. Sepse, askush që ka pasur shumë fëmijë nuk është fikur, por vetëm janë shtuar", thotë ai.

Tash bashkëshortët Zogiani jetojnë të lumtur me fëmijët e tyre. E, kur nuk i kujtohet ndonjëri me emër, gruaja i ndihmon... Dhe, kur jemi te harresa, Milaimi tregon një histori dhe thotë:  
"Një natë, pasi i shtrimë në dhomë në sfungjera për të fjetur, nisa t'i normoja. Më doli një fëmijë mangu. I numërova dhe një herë, por përsëri një mun-gonte. Gruaja më pyeti:  
"Çka po bën?".

I thashë, po i numëroj, por një po më del mangu.

I numëroi edhe ajo dhe njëjtë i doli.

Dhe, u shqetësuam... Njëri fëmijë ishte fshehur nën jorganin e tjetrit...".

Dhe, teksa largohem nga Mi-laimi, nëpër oborr nuk shoh edhe aq fëmijë, sepse ndonjëri është në shkollë, të tjerë në ara...

**Safet Krivaça**



# *Kush po e shëmton bukurinë e fshatit Gadime?*

*Fshati Gadime është fshati më i madh në komunën e Lipjanit, me 18 mijë banorë. Në fshat më nuk ka rrugë e as rrugica pa asfalt, kështu që më këmba nuk të shkel në baltë.*

Gadimja, me kodrat "Murturi" dhe "Surgjaku", mbi të cilat shtrihen pishat dhe malet, te vendi "Pishat" po punohet për rregullimin e një shëtitoreje urbane, vend ku deri më tani kanë dominuar ujqit, dhelprat dhe macet e egra.

Dy rrugë qojnë te shëtitorja e re që po e ngritë komuna e Lipjanit. Njëra prej rrugëve që qon te shëtitorja, ku gravitojnë, së paku, 700 familje, është krim ekologjik. Nga të gjitha anët aty i sjellin bagëtitë e ngordhura, mbetjet e kurbaneve etj.

Prania e qenve të rrezikshëm që shkojnë pas coftinave është e madhe.

Pranë varrezës së re, që ndahet nga toka ish-kolektive, kalimi është i pamundur, sa shkaku i qenve, po aq i kutërbimit.

Dhe, veç gjërave që i përmendëm, ajo pjesë është shndërruar në deponi bërlloku. Gjatë natës nga kamionët hedhen mbetjet ndërtimore, goma

automjete, dyshekë, shtretër, thasë të mbushur me gjësende medicinave dhe rroba të të vdekurve.

Të gjitha këto janë të pranishme në vendin "Lugu i Sylës", afër gurthyesit "Niti", deri te gurëthyesi "Gërlica", rrugë që qon te shëtitorja e re.

Dhe, për çudi, politikanët komunalë heshtin për këtë deponi të rrezikshme, ku vend kanë gjetur qentë endacakë, për krim ekologjik që e ka shkatërruar fshatin më të madh në Kosovë, me 18 mijë banorë, Gadimen.

## **NË TUNELE FUTEN MATERJET EKSPLODUESE!**

Katër gurëthyes e shkatërrojnë fshatin nga pluhuri i mjeteve të rënda transportuese. "Te pishat", e që u shërbente shkollave dhe nxënësve për ekspursion dhe kroset pranverore e vjesh-tore, ajo pjesë është uzurpuar nga një

qytetar i Gostivarit të Maqedonisë! Dikush thotë se ia ka shitur komuna, dikush thotë atë e ka ndihmuar PDK-ja nën qeverisjen e Shukri Bujës, dikush... Por, askush nuk e di të vërtetën e këtij uzurpimi, në të cilin ka filluar të ndërtohen restorante, kafe dhe çka jo tjetër... Dhe, ai uzurpim, fillimisht, ka ndodhur nën pretekstin e ngritjes së një ferme të dhive. Pastaj, janë ndërtuar disa shtëpi dhe është zgjeruar uzurpimi... Po ashtu, nën kodër ndodhen disa tunele, e që posedojnë materie të rrezikshme eksploduese, për të cilat kurrë askush nuk e ka pyetur popullin. Andaj, gadimasve u është zënë fryma me ndërtim e uzurpime, me gurëthyes që operojnë edhe pa leje... Kështu, një vend me oksigjen i Lipjanit, Gadimja, më nuk është funksional dhe po "vdes" dita-ditës, ndërkaq asfaltet rrugore lulëzojnë nëpër lagje e mëhalla.

**Safet Krivaça**



# Fluturime direkte të sigurta dhe komode drejt Prishtinës dhe Shkupit. Rezervo tani!

**Düsseldorf**

« Prishtinë

**Stuttgart**

« Prishtinë

**Frankfurt**

« Prishtinë

**Hannover**

« Prishtinë

**München**

« Prishtinë

**Hamburg**

« Prishtinë

**Zürich**

« Prishtinë

**Zürich**

« Shkup

**Basel**

« Prishtinë



Easier way **to fly.**

[flyksa.com](https://flyksa.com)

KOSOVA AIRLINES

eurokoha

*Bisedë me Ajshe Gjonbalajn,  
ish-e burgosur politike*

# "Më mbajtën në qeli të ftohtë, që të vdisja ngadalë"

Ajshe Gjonbalaj

*Ajshe Gjonbalaj, nga Vuthaj, e burgosur politike e viteve 80, ka qenë pjesëmarrëse e demonstratave më 1968 dhe 1981, ku edhe është dënuar me burg 13 vjet, e që shtatë prej tyre i ka vuajtur në disa burgje, shumicën në burgun e Pozharevcit, në Serbi.*

## **Kush është Ajshe Gjonbalaj?**

- Jam e lindur më 1 tetor 1948, në Vuthaj, në Mal të Zi. Shkollën fillore e kam kryer në Vuthaj, normalen në Pejë, kurse Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, më 1971. Kam punuar dy vjet në vendlindje, kurse 11 vjet në Shkollën fillore "Ganimete Tërbeshi" në Llukar, komunë e Prishtinës. Jam pjesëmarrëse e demonstratave të vitit 1968 në Pejë. Në Prishtinë mora pjesë në demonstratat e vitit 1981. Më arrestuan më 23 mars 1984, në Prishtinë, në vendin e punës ku punoja, pra në shkollë, në Llukar. Dënimin me burg e mbajta nga 23 mars 1983 deri më 29 nëntor 1990. Tash jetoj në SHBA. Nuk jam martuar asnjëherë.

## **Na flisni për fëmijërinë tuaj?**

- Prindërit e mi kanë qenë shembullorë. Babai Ramë Qerim Gjonbalaj dhe nëna Zojë Balidemaj, janë kujdesur shumë për ne dhe shkollimin tonë.

Kemi qenë katër motra e dy vëllezër dhe prindërit e kanë shitur kafshatën e gojës për të na shkolluar. Deri në moshën 15 vjeçe kam qenë nxënëse në dy shkolla: në Vuthaj e Guci, kurse pas kësaj moshe jam ndarë nga prindërit për të vazhduar shkollimin në Pejë. Prindërit nuk punonin askund, andaj janë munduar shumë për ne, fëmijët, duke u marrë me gjëra të bujqësisë. Na kanë shkolluar e rritur me shumë mundime... Ishte vështirë të kërkonim para nga babai, kur e dinim se nuk ishte në marrëdhënie pune...

## **KËMBË NGA VUTHAJ NË PEJË!**

**Keni bërë udhë në këmbë nga Vuthaj në Pejë. Na i tregoni detajet e asaj sfide?**

- Kur erdha të regjistrohesha në Pejë, erdha me nënën. Ajo hipur në kalë, kurse unë ecja këmbë. Dhe, nga ajo

kohë e deri në fund të shkollimit tim, për çdo festë unë dhe nxënësit tjerë të anës sime shkonim në vendlindje. Pra, udhëtonim nga Vuthaj në Pejë dhe anasjelltas. Kalonim kah vendi "Qafa e diellit" nëpër Çakorr. Dimrit binte borë e madhe në Çakorr. Ishte rrugë me rreziqe...

Sa herë që udhëtonim, kah ora 2 pas mesnate, takoheshim ne, nxënësit, nga fshati Martinaj, Gucia, Plava, Vuthaj dhe vendet e tjera dhe niseshim bashkërisht për në Pejë dhe anasjelltas. Vetëm nga Peja për në Kuqishtë bënim 4 orë e gjysmë në këmbë. E, ku pjesa tjetër e rrugës?

## **A keni pasur rastin të keni probleme me ndonjë nxënëse gjatë rrugës?**

- Ka ndodhur ndonjë nga nxënësit në rrugë edhe të sëmurët nga udhëtimi i gjatë. Dhe, kur sëmurë ndonjë nxënëse rrugës, ia fërkonim fytyrën me borë. Unë isha më e vogla prej të gjithëve, se



kishte edhe më të moshuar. Mbjaj mend që më caktonin të ecja e para, t'më kishin nën përkuqdesje si më të voglën e grupit, ashtu që t'më kishin në çdo moment para syve. Rruga, zakonisht, bëhej për festa, d.m.th., 4 herë çdo vit shkollor.

### Si u trajtonin në Pejë?

- Na trajtonin mirë. Rexhep Podrimja, profesor, më thoshte - ti je vajza ime, Avni Lama sillej mirë me ne, pastaj profesor Aliu, edhe ai ishte i shkëlqyeshëm, sikur edhe Sylë Dreshaj dhe Sali Likaj, që më kishte regjistruar në shkollë, në Pejë. Gjithashtu, edhe të tjerët na trajtonin shkëlqyeshëm dhe na donin shumë. Kishim autoritet të madh dhe shoqëri të mirë. Banoja në Pejë, kurse në vizitë shpesh më vinte nëna dhe, si gjithherë, rrugën e bënte hipur në kalë deri në Pejë.

### E, pasi e kreve shkollën në Pejë?

- Kur e kreu shkollën normale në Pejë erdha në Prishtinë, për t'u regjistruar në SHLP. Pas kryerjes së SHLP-së u ktheva në vendlindje, ku edhe punova dy vjet. Kisha dëshirë të punoja atje se kishte nevojë populli për mua, si të them, t'ua qel sytë...

Por, shpejt rashë në sy të pushtetit, sepse asnjëri arsimtar deri atëherë në librin e kujdestarisë kurrë s'kishin shkruar shqip dhe unë isha e vetmja që e bëja në shqip raportin ditor. Unë nuk dija që ishte e ndaluar të shkruhej shqip. Neve, që ishim shkolluar në Kosovë, në Vuthaj na quanin nacionalistë. Drejtori malazez, Çedo Vukoviqi, më thirri të raportoja pse kisha shkruar shqip. Nuk e dija mirë serbishten. I erdhi rëndë drejtorit kur i thashë nuk di mirë serbisht. Ai e thirri ish-kujdestarin tim të klasës, arsimtarin Hysen Nimanin dhe e urdhëroi t'më mësonte që edhe unë të shkruaja serbisht.

## U LIND NË BURG DHE VDIQ NË BURG!

### Je burgosur. Si rrodhi ngjarja?

- 18 vetë na kanë burgosur. Ishim përcjellë në demonstratat e vitit 1981. Kryetari ynë i grupit ka qenë Rifat Kafexholli. Grupi ishte shumë aktiv dhe i guximshëm, aq sa na quanin "bom-baçët", grup që njiheshim si minues të Jugosllavisë!

Dy net burg të rëndë i kemi mbajtur në Prishtinë, ditët tjera në Mitrovicë. Një vit u mbajtëm në burg nën hetime në



Demonstratat e vitit 1981 në Plavë

Mitrovicë. Na kanë rrah shumë... Pastaj, na e shqiptuan dënimin në Prishtinë. Rifati u dënua me 20 vjet burg, unë me 13, kurse vëllai im, Beqiri, me 2 vjet. Nuhi Bunjaku me 15 vjet burg, Shaqir Ruhani me 15 vjet, Hazir Xhafolli me 12 vjet burg, Nazmi Krasniqi vdiq në qeli, në Pozharevc, në burgun qendror. (Interesante: Nazmiu ishte i lindur në burg nga nëna e burgosur dhe vdiq në burg, tash si i burgosur).

Gjithashtu, shumë prej të burgosurve të grupit tonë kanë mbetur me pasoja të përrjetshme, ku dy prej tyre edhe kanë vdekur në burg. Disa prej tyre edhe tash janë psikikisht keq, e disa me pasoja të tjera fizike. Sidoqoftë, të gjithë kanë qenë të shkatërruar.

### Si ndodhi lirimi yt nga burgu?

- Kur dola prej aty, mendova se ma ndërronin burgun. Lëshonin rrena të përditshme dhe nuk u besoja që lirohesha. Kam dal me rroba të burgut nga burgu i Pozharevcit. Më kishin amnistuar në festën e 29 nëntorit për Jugosllavi, më 1990. Ishte amnistia e fundit për lirime politike në atë shtet.

### A ke qëndruar edhe në qeli të burgut?

- Në Pozharevc kam bërë burg qeli më qeli. Në një rast erdhi të na vizitonte Kryqi i Kuq dhe policja më tha se më kërkonte dikush për vizitë. Unë bëhesha se nuk kuptoja gjë. Kisha dyshimin se vinin nga Beogradi t'më provokonin, pasi shpesh ndodhte kështu. Shokët e mi i kishin thënë Kryqit të Kuq t'më intervistonin si rast i veçantë. Kërkuan nga unë t'u tregoja se si më trajtonin në burg. U tregova në hollësi për të gjitha torturat... Në fund, ua dhashë dorën e u thashë: "Unë u tregova gjithë çka kanë bërë në mua..."

Pse të frikësohesha të tregoja kur e dija se edhe ashtu do më maltretonin edhe në të ardhmen, siç ishte edhe në kohën e shkuar... Bile, të tregoja krejt se çka ndodhte aty...

Pasi kryen punë ata shkuan. Dhe, në fillim të atyre ditëve nuk më ndësh-

kuan për ato që i thashë. Pas një muaji i nxorën do kushte që nuk mund t'i bëja, andaj 6 javë më dënuan të qëndroja në qeli të errët, duke fjetur në dysheme. Për fat të keq, në burgun e Pozharevcit ka qeli të rënda dhe unë kam kaluar nëpër 4-5 sosh...

### Na e përshkruaj ndonjë detaj në qeli?

- Një nate të ftohtë, kah gjysma e natës jam zgjuar nga të ftohtit dhe kam filluar të lëviz nëpër qeli. Nga lëvizja e gjatë u nxeha dhe para mëngjesit përsëri më kishte zënë gjumi...

Por, më zgjuan udbashët, duke bërë titur: "A hala gjallë qenke bre nënën...". Kishin pritur të vdisja në qeli nga të ftohtit e madh që bënte ato ditë... Prandaj, e kup-tova pse më mbanin mu në atë qeli... Edhe një rast tjetër interesant: në burg ishte radioja, nga e cila lëshonin muzikë serbe. Radioja ndodhej në fillim të korridorit të gjatë.

Një ditë, kur më erdhi radha ta pastroja korridorin, u afrova te radioja dhe fillova t'i ndërroja stacionet. Për çudi, hasa në "Radio Kukësin", e që në atë moment ishte duke kënduar Dervish Shaqa! Ishte kënga "E lashë verë e gjeta dimër". Dhe, ato pak çaste, derisa nuk ma ndërruan stacionin, m'u duk se fluturoja maleve të Malësisë së Madhe...

Por, u bë bujë e madhe se kush e kishte lëshuar radion, e unë nuk pranoja kurrsesi... Por, pas pak u zbulua se unë e kisha bërë një gjë të tillë...

### Dhe, cili ishte dënimi?

- Më dënuan të punoja punë të rënda, të bartja paketa të rënda. Në ato paketa kishte shporet elektrik.

### Si ishte momenti i lirimit?

- Ishte festa e 29 nëntorit dhe unë kisha përfituar lirinë si e amnistuar. Lirimi im ishte amnistia e fundit që ndodhi në Jugosllavi. Mendoja se ma ndërronin burgun dhe nuk kisha idenë se më lironin.

Por, një gjë e tillë ndodhi...

**Safet Krivaça**

*Në maje të një kodre jo fort të lartë, me shekuj, pa u lëkundur, rri ende guri i Mujës. Gjurmët e ekzistencës së tij po ruhen ende në Morinë të Skenderajt. Me një diametër rreth një metër e gjysmë, guri, që Muja sipas legjendës e kishte gjuajtur nga Çyçavica në fshatin Morinë (Marinë) të Skenderajt, qëndron ende aty.*

Ai nuk ka lëvizur asnjëherë nga ai vend, ku, sipas banorëve vendas, e kishte hedhur Muja. Banorët e fshatit Morinë besojnë se tre gurët (njëri i Mujës, njëri i Halilit dhe një i Talit), janë të shenjtë dhe askush deri më tani, siç rrëfejnë banorët, nuk ka guxuar dhe as nuk guxon t'i dëmtojë. "Kush guxon të prekë këta gurë e zë mallkimi", është amaneti që përcillet brez pas brezi.

Asnjëherë nuk ka ndryshuar pamja e tyre. As bora nuk rri mbi ta. Frika nga mallkimi i gurëve dhe pasojat ka ruajtur formën e gurëve dhe i mban të padëmtuar me shekuj, pas legjendës së thurur për Mujën e Halilin.

Një plak kishte pas tentuar ta thyjë njërin gur. Plaku kur ishte kthyer në shtëpi i kishte gjetur të çmendur familjarët...

Edhe gishtat e dorës së Mujës janë në guri, por ajo pjesë shihet më pak, meqë është në pjesën e gurit që rri në tokë.

## **MISTERI I VDEKJEVE PAS PREKJES SË GURIT**

Një ngjarje që e mbajnë në mend më të moshuarit e fshatit është ajo kur është ndërtuar shkolla e fshatit Morinë, në vitin 1996. Kur është ndërtuar shkolla e kanë lëvizur gurin. Por, në mbrëmje të katër mjeshtërit kanë pësuar aksident dhe kanë vdekur.



Guri i Mujës në fshatin Morinë të Skenderajt

# **Pse njerëzit vdesin kur e prekin gurin e Mujës?**

Për gurin e Mujës, që është i shpuar në mes, thuhet se çdo vit nga vrima del një gjarpër.

Shkurt, kushdo që i ka prekur ata gurë ia ka pa sherrin. Janë bërë me behane, thonë të moshuarit e fshatit Morinë të Drenicës...

Banorët e kësaj ane thonë se në malin pranë fshatit është edhe fërkemi i kalit

të Mujës, është shumë i madh dhe kurrë nuk është dëmtuar. Atë nuk e mbulon dheu.

Të tre gurët: i Mujës, i Halilit dhe ai i Talit, janë pranë shkollës së fshatit Morinë, ndërsa fëmijët rriten duke mësuar legjendën për gurët dhe për fatkeqësinë që sjellin nëse i dëmtojnë...



# Irralli...

*Nuk ka njeri që nuk e adhuron artin e bukur. Edhe fotografia është art. Arti fotografik është një profesion i rrallë i jetës. Kjo është jo vetëm dhuntia e profesionistit, por është edhe “zanat” i dijes. Dhe, një nga ata që e kanë “zanat” artin fotografik është Sadri Hadërgjonaj, mjeshtër i fotografisë artistike.*

Kur mungon fotografia, shkrimi është i “thatë”, pa shije. Njerëzit më shumë i besojnë fotografisë se shënimit. E, Sadri Hadërgjonaj e ka këtë “zanat” jete, i cili, jo vetëm se i sjell të mira jete shpirtërore, por edhe e ka hobi jete e pune.

Ai, duke dashur fotografinë, ka bërë

shumë gjëra të mira. Ka udhëtuar anë e kënd botës. Është bërë një udhëtar me eksperiencë të ndryshme të punës së tij. Jeta e ka “shoshitur” të jetë edhe përkthyes, madje autor i poezive, por edhe të shkruajë reportazhe e të njohë njerëz të shquar të jetës letrare. Thotë se qysh në vitin 1957 e ka blerë aparatën e fotografisë. Dhe, jo vetëm kaq...

Ai fotografitë e tij i ka ekspozuar në shumë vende. Dhe, kudo që janë ekspozuar, janë pritur me interesim të madh nga të gjithë. Sepse, artisti i madh e gjen artin që e pushton botën...

Ai ka pasur disa ekspozita me fotografi, ndër të cilat është veçuar ajo në ambientet e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, me rastin e 100-vjetorit të Shqipërisë, me titull “100 etnoportrete për 100-vjetorin e Pavarësisë së shtetit Shqiptar”. Por, edhe shumë të tjera...

Sadriu, si frymëzim, e ka fëmijërinë dhe fshatin e tij të lindjes, Pobërgjen,

komuna e Deçanit. Ai është paraqitur në më se 30 ekspozita personale dhe kolektive në vende të ndryshme të Kosovës, Ballkanit dhe në Shtetet Skandinave.

Te artisti Hadërgjonaj gjejmë shembullin e dashurisë për vendin e të parëve, për bjeshkët e vërrinit, për qytetet e fshatrat e bukura kosovare. Dhe, pa dyshim, Sadri Hadërgjonaj e ka një botë më të veçantë se krijuesit tjerë të artit...





# Çdo dashuri e ka edhe një çmenduri!

*Dikur e diku, buzë një mëngjesi të ngrysur, në një gazetë koti po plakja kohën, kur në një moment mbeta e shtangur dhe e habitur me atë se ç'po lexoja...*

*Nuk di si ta përshkruaj atë “goditje nën brez”: flakaresh kurioziteti apo një dush i ftohtë, i cili më kthjell mendimet e mjegullta, që më pushtojnë pa mëshirë kur zgjohem e etur për gjumë.*

U shtrëngova fort për karrige, teksa po shtypja gazetën për tavolinën e rumbullakët prej druri, që prej sa isha aty, dukej akoma më e fortë sesa isha unë. Ishte e vjetër, funksionale, por bënte nazet e saj prej pleqërie. Në atë gazetë ishte një shkrim që

pasqyronte karakterin dhe personalitetin e njeriut. Nuk ishte kush e di sa, por mjaftueshëm sa për t'më ngjallur e rizgjuar nga letargjia rutinore. Dhe, nuk mjaftohem me pak, porse gjithçka fillon nga më pak se që quhet pak. Bla, bla, bla... nuk e gjeja veten

ndokund, por në fund të fundit autori determinonte tri maskat ditore të njeriut.

Dhe, pa dyshim, në këtë skenar koti, kërkoja të timen maskë, në këtë kinema a teatër prej së vërteti. Kjo ishte pjesa më produktive, mendova,



ani pse ishte çështje filozofike e tëra dhe se filozofia për mua është mullari i gjithë idotllëkut që mund të prodhojë e miksojë mendja njerëzore.

Më tutje, thoshte se njeriu ka një karakter që e shfaqë para të tjerëve, një tjetër që e shfaqë para vetes së tij, e në fund është ai karakteri i vërtetë, që i vijë turp t'ia shfaqë qoftë edhe vetvetes.

Madje, ai ngulmonte se njeriu është ajo ëndrra e tij që nuk ka guxim t'ia tregojë vetes. Kjo më bëri përshtypje, mbase përshtypja e parë mundëson mundësinë e dytë.

## KUSH JAM UNË? PSE JAM UNË?!

Pyeta veten: Mos, vallë, jam edhe unë e tillë?! Kush jam unë?!

Kam emër, mbiemër, vajza e dikujt, tifoze këtu, fanatike atje... Kjo përzierje më flakte drejt një ferri monoton (thuaje ka ferr që më pëlqen).

"Kush jam unë?!", kishte aq shumë përgjigje, sa që më vinte turp për pyetjen që doja t'i përgjigjesha. Dhe, çdo përgjigje që jepja më bënte më pak unike, të mos flas për diçka të veçantë...

Unë, thash, unë dhe vetja ime. Dy personazhe në një trup të vetëm. Emocionet e mia, arsyet e mia, shpirti im, vetëdija, nënvetëdija... Po më lodhte që në fillimin e ditës ky drejç rubikoni. Ta zgjidhja nuk mundja, ta lija më helmonte inati thellë në mua.

U riktheva sërish te gazeta. Isha bërë xhelati i saj. Po e ekzekutoja në giotinën e kërshërisë time të çmendur. E, kur jemi të çmenduria, dëshira dhe dashuria për të ditur dhe njohur veten time jo që më çmendte, por më çnjerëzonte në ato çaste. Niçe thoshte se çdo dashuri ka një çmenduri dhe çdo çmenduri ka pakëz arsye!

Isha një e çmendur e arsyeshme, teksa po vrisja mendjen 10 herë në 20 mënyra të ndryshme brenda atyre 30 minutave dhe po merrja vëmendjen e gjithë kafiterisë.

Gjurmoja edhe më shumë në gazetë, por çdo gjë ishte e kodifikuar. O ishin kode Da Vinçi, o nivele të lojës së Super Marios, që duhej të filloja t'i zgjidhja ato lëmshe idesh që nga filli i fillimit të tyre të pafund.

Një enigmë që zgjatet bëhet mister, e mister i bëhet asgjë nëse harrohet dhe asgjë nëse kuptohet.

Dreqin, po filozofoj edhe unë! Por, në mes mungesës së dritës dhe dritës së pakët, lind një fije iluzioni. Kujtoja se sa herë isha e vetmuar dhe nuk jam ndjerë asnjëherë e tillë. Flisja me veten dhe shoqërohesha nga vetja ime në disa raste kritike, nëse mund t'i quaj ashtu.

Këshillohesha nga vetja dhe dënohesha nga vetja. Vuaja ose gëzoja pasojat e veprimeve të mia, të pandikuara nga jashtë. Një hap para, dy mbrapa ose një mbarë e dy mbrapshtë, siç thotë populli.

E, kur jemi te populli, shqetësimi im kishte pushtuar kërshërinë e gjithë njerëzve në kafiteri. Të gjithë kokë e vesh kah unë... Më shikonin me të qeshura e të qara, më fyenin, ndoshta edhe më përqeshnin... Përveç një plaku afër meje, që nuk shinte e as dëgjonte, e as që e mundonte trurin për masakrën që po i bëja asaj të mjere tavoline. Ishte i mbytur në duhan e në mendime, veçse ishte ekstremi i qetë përballë meje.

Unë mbaja një qëndrim kinse pozitiv dhe u buzëqeshja gjatë gjithë kohës. "Çmenduria e buzëqeshur", ilorizonte njëri. Më tutje njëri: "Më dhimbset, është e re!".

## UNË JAM UNË DHE NUK BËHEM TI!

Sidoqoftë, mbështolla gazetën dhe po bëhesha gati të ikja pa u bërë gaz i botës. Nuk dija se kush isha, nuk e dija se ç'jam e çdo të jem... Trinomi i famshëm i Sami Frashërit, mendova. U mbështolla me shallin rreth qafës, mbi supe vura xhakëtën, e çantën me libra po e mbaja në dorë, teksa po kërkoja me sy shportën më të afërt për të hedhur atë gazetë djalli, pa i dhënë lamtumirën e ferrit.

"Ti je ti, bija ime. Ti je vetëm ti dhe askush tjetër", foli plaku i heshtur pranë meje.

Unë isha duke ikur në ato momente, por plaku më mori mendjen dhe nuk kisha kohë për çmendurinë time, e lëre më për çmendurinë e tij të pluhurosor.

"Ndal, bija ime!", më tha.

Gjithë njerëzit aty u habitën, e, ndoshta, menduan: "Hë, i dyti ky!".

"Ti je ti, unë jam unë, këta janë këta dhe ata janë ata", gumëzhiu plaku.

Unë ula kokën dhe po e drejtoja veten kah dera pa bërë zë. Të tjerët vetëm dëgjonin.

"Ndal!", më bërtiti.

Ndalova.

Ai vazhdoi:

"Ne jemi, prandaj ekzistojmë. Dëgjova çfarë po flisje me veten dhe kuptova se ç'po mendoje... Isha krah teje. Unë nuk jam shurdhmemec, vetëm i moshuar. Jo vetëm ti, por secili këtu nuk e di se kush është vetja e tij. Jemi, pra, ata që jemi. Unë jam unë dhe nuk bëhem ti. Ti je ti dhe nuk bëhesh unë.

Dhe, kjo ndasi e veçantë nuk na bënë të veçantë, por na bënë edhe unikë e të patjetërsueshëm.

Jeta mund të jetë pa kuptim, por, njëkohësisht, mund të ketë edhe shumë kuptime. Thjesht, jeta ka shumë kuptime të pakuptueshme. Është, thjesht, një enigmë e vogël, që zgjatet e madhështohet me kohën e bëhet një mister. Mister i dashur ose jo, mbetet një e pazgjidhur, përgjithmonë...

Dhe, ne, dëshprueshëm mundo-hemi të gjejmë kuptimin e pashpjegueshëm, por të vërtetë, që rrotull kësaj rrokullie imagjinare bën që vetë jeta jonë të jetë tutorja e jetës sonë. Vërtet, një iluzion, për të mos thënë "gënjeshtër".

Ne orvatemi thellësisht që të gjejmë qëllimin e jetës sonë. E kërkojmë vetveten, e kërkojmë idealin e vërtetë, të vërtetën ideale.

Ne jemi ata që ekzistuaam dje. Ekzistojmë tash.

E, nesër? A do të ekzistojmë nesër? Ne jemi ata që, vërtet, ndjejmë natyrshëm dhe ndjejmë arsyeshëm. Magjia shtohet edhe më tej kur e dimë se çka dhe si ndihemi dhe kush edhe çka jemi, vërtet.

## SI TA PËRMBYLLË KËTË SHKRIM?

Dramën e kam dashur gjithmonë, por unë ika nga "filmi", për te uni im...

Dhe, nëse nuk e gjej, do e krijoj, sepse unë jam unë, prandaj ekzistoj...

**Flakë Ajeti**



# Sa herë në javë bëjnë seks shqiptarët?

*Te popujt tjerë evropianë, çështja e të bërit seks bisedohet e komentohet shumë, si në mjetet e informimit të shkruara, ashtu edhe në ato elektronike. E, te ne, në Kosovë, si është puna në këtë aspekt?*

Të pakta janë mjetet e informimit që shkruajnë a japin emisione televizive për seksin në Kosovë, sepse e konsiderojnë si problem personal çështjen e seksit e jo në nivel shoqëror. Pra, janë të paktë edhe njerëzit që flasin haptazi për seksin... Megjithatë, seksologët, në raste të caktuara, dalin në ndonjë emision televiziv apo edhe në ndonjë revistë a gazetë me ndonjë shpjegim për seksin. Një ndër ta është edhe seksologu Hajrullah Fejza, i cili herë pas

herë flet për problemet seksuale të rinjtë, kryesisht, por edhe për të rriturit.

Fejza thotë se problemet janë të shfaqura edhe te çiftet që kanë nga shtatë e më shumë vite martesë dhe se ato probleme lidhen me dëshirën për të kryer marrëdhënie seksuale.

"Për dikë mjafton me bë seks një herë në vit ose në muaj, tjetri ka nevojë me bë seks çdo natë. Shumica e problemeve janë me bazë psikologjike dhe kërkojnë trajtim psiko-seksual. Kjo vjen si mungesë

e edukimit seksual në shkollë, si mungesë e komunikimit", ka thënë Fejza.

Ai tha se njerëzit të seksologu nuk shkojnë vetëm për këshillime, por edhe për shërim, me barna.

"Meqë jemi në verë, edhe pse është nxehtë, mos e shmangni seksin, sepse seksi është i nxehtë dhe është ajo formula që i nxehti mposhtet me të nxehtë. Pasi që të kryhet marrëdhënie seksuale, trupi ftohet dhe është në gjendje sikur të qëndrohet në një ambient me klimë", ka deklaruar ai.



Model: Visar Sinani

# BOOM

Këngëtarët  
shqiptarë  
kurbetçinj

Si të dobësoheni si  
Capital T, Big Mama,  
Gili, Anxhela?

10 të famshmit  
që duhet t'i ndiqni  
në Snapchat

**Visar Sinani,**  
*imazh  
i mashkullit  
ideal*

*Falë famës dhe karrierës së ndërtuar ndër vite, shumë nga personazhet e famshëm shqiptarë kanë arritur të krijojnë edhe një standard të lartë të jetesës. Janë fokusuar në ndërtimin e karrierës në Shqipëri dhe Kosovë, ndërsa koncertet e mbrëmjet muzikore u kanë mundësuar të vizitojnë vende të ndryshme. Por, jeta e tyre jo gjithmonë ka qenë e tillë. Disa nga artistët tanë, shumica për shkaqe ekonomike, ishin emigrantë në shtete të ndryshme të botës. Pra, cilët janë personazhet e famshëm shqiptarë që jetuan dikur si emigrantë?*



### BLERO

Blero ka jetuar në Suedi, por është kthyer qe disa vjet në Kosovë. Megjithëse Blero është vendosur në Prishtinë, ku edhe ka krijuar jetën e tij, familja e Bleros vazhdon të jetojë në Suedi. Ndërkaq, bashkëshortja e tij, Afrona, jeton në Zvicër.

# Këngëtarët shqiptarë kurbetçinj

### MIRIAM CANI

Miriam Cani u bë e njohur në Gjermani, pasi fitoi një talent-shou, duke u përzgjedhur si pjesë e grupit pop të vajzave "The Predulers".

Por, edhe pasi grupi u nda, ajo vijoi karrierën në Gjermani, këtë herë si moderatore e programeve muzikore në televizionin gjerman.

Më vonë nisi të bëjë karrierë edhe në vendin e saj, fillimisht duke marrë pjesë në "Festivalin e Këngës", e më pas me "Chicago", muzikalin që e bashkoi me Alban Skenderajn, çka do ta sillte përfundimisht Miriamin në Shqipëri.



### DAFINA ZEQRIRI

Dafina Zeqiri është e lindur në Suedi, ku është shkolluar dhe ka nisur të këndojë, duke marrë pjesë në festivalet e zërave të rinj.

Por, për të ndjekur karrierën e saj muzikore, ajo u kthye në Kosovë kur ishte 16 vjeçe, ku më vonë publikoi disa këngë që do e bënin të famshme.

Fillimisht këndoi këngën "La Vida Loca" me Bleron dhe F Kay, e më pas "Amazing Girl", ndërsa suksesin më të madh do ia jepte kënga "Ti po m'pëlqen" me Ledrin.

Jeta dhe karriera e Dafinës vazhdon në Kosovë...






## GENTA ISMAJLI

Genta Ismajli ishte foshnje kur familja e saj u vendos në Amerikë. Por, ajo nuk e humbi lidhjen me vendin e saj dhe në moshën 19-vjeçare u kthye në Kosovë, ku do të bëhej menjëherë e njohur me këngën “Dridhem”.

Edhe pse më vonë është përpjekur të hyjë në tregun muzikor amerikan, Genta është shprehur se nuk është aspak e thjeshtë të bëhesh pjesë e asaj industrie. Ajo ka publikuar disa këngë me producentë të huaj, por pa mundur të përfshihet në top-lista.

Këngëtarja është martuar në Turqi.



## NOIZY

Në vitin 1997, Rigels Rajku, bashkë me familjen e tij, udhëtuan për në Angli, për të kërkuar një jetë më të mirë.

Siç ka treguar Noizy, ai ka jetuar në një prej lagjeve më të rrezikshme të Londrës, ku ka mësuar edhe të ndeshet “street fight” (“ndeshje rruge”).

Ishte pjesëmarrës në këngën magjikeb, me këngën “Veç për ty”, në vitin 2007, që do e bënte të njohur në Shqipëri.

Më pas, Noizy do të kthehej në Shqipëri, duke u bërë një prej reperëve më të famshëm, bashkë me grupin e tij “OTR”.



## UNIKKATIL

Kur Unikkatil mbajti një koncert në Prishtinë në vitin 2012, salla u mbush plot. Sepse, reperi i grupit “TBA” ka ruajtur gjithnjë një lloj misteri, duke qenë se jeton në Amerikë, në Nju-Jork. Ai është larguar bashkë me familje nga Kosova në kohën e luftës dhe atje ka krijuar studion e tij të punimit të këngëve, si edhe grupin e famshëm “The Bloody Alboz” (“Shqipet e përgjakura”), të njohur si “TBA”. Emri i tij është Viktor Paloka.



## AURELA GAÇE

Këngëtarja nga Vlora u nis për në Amerikë në vitin 2002, pasi fitoi një sërë çmimesh në festivale dhe solli shumë hite që do të mbaheshin mend gjatë.

Ajo do të shkonte në Shtetet e Bashkuara të Amerikës bashkë me motrën e vogël, Blertën, e cila ka treguar se, edhe pse ishin jashtë vendit, Aurela e “llas-tonte”, duke punuar për të dyja, ndërsa Blerta i vazhdonte studimet.

Aurela në SHBA këndoi në shumë koncerte për komunitetin shqiptar në Amerikë. Në vitin 2004 këndoi himnin shqiptar para Bill Klintonit.

Megjithatë, ajo vendosi të kthehej në Shqipëri në vitin 2006, kur ishte e ftuar speciale në “Festivalin e Këngës”, duke u shfaqur në skenën shqiptare për herë të parë pas shumë vitesh.

## MERITA HALILI

Këngëtarja e mirënjohur e folkut të Shqipërisë së Mesme ka nisur të këndojë që në moshë shumë të re. Në vitet 90, si shumë artistë shqiptarë, ajo u shpërngul me familje në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku vijoi të këndonte për shqiptarët, por edhe për amerikanët, duke përshtatur edhe motivet shqiptare në anglisht, që këngët të kuptoheshin edhe nga publiku i atjeshëm.

Gjithmonë me bashkëshortin, ajo merr pjesë në shumë koncerte...



## ELHAIDA DANI

Këngëtarja shkodrane u bë e njohur pasi fitoi “Star Academy” në vitin 2009 dhe “Top Fest” në vitin 2012.

Po atë vit, ajo u vendos në Itali, ku u shpall fituese e “The Voice of Italy” dhe emri i saj u bë i njohur në botë, pas pjesëmarrjes në festivalin “Eurosong”.

“Boom”

*Visar Sinani është histori në vete, person i zgjuar, i pashëm, energjik, inovator dhe i pandalshëm në rrugën e suksesit. Ata që e njohin nuk kursen një fjalët më të mira për të dhe krejt çka ai bën. Me origjinë nga Shkupi, por i rritur në Zvicër, është djalosht sportiv, origjinal, kreativ dhe me stil.*

*Visar Sinani, së fundi, është përkushtuar plotësisht në organizimin e “Gala of the Eagle”, mbremje që do të mbahet në hotelin dhe resortin me 5 yje, “Bad Ragaz Grand Resort”, ku yjet e vërtetë të muzikës shqiptare do të arrijnë në Zvicër, në këtë resort, më 15 tetor 2021.*



**Visar Sinani,**  
*imazh  
i mashkullit  
ideal*



### Visar, të flasim pak për ty...

- Jam 36 vjeç, i lindur në Shkup, në komunën e Çairit. Atje kam jetuar deri në moshën 5 vjeç, me nënën dhe gjyshërit, meqë babai, shkaku i kushteve, kishte emigruar në Zvicër, për të punuar. Nëna dhe gjyshja më rriten me shumë dashuri. Babanë e njoha tek kur isha 5 vjeç.

### Si ishte fëmijëria jote?

- Në vitin 1991 babai na mori mua e nënën në Zvicër. Ndarja nga gjyshi dhe gjyshja ishte tejet e rëndë, meqë isha mësuar me ta...

Babai punonte në Aorsa (vend turistik) dhe kjo e bëri fëmijërinë time më të bukur dhe atraktive. Ditën e parë kur erdha në Zvicër kishte borë rreth dy metra, njerëz që skijonin, e që unë as nuk e dija se çfarë bënin. U rrita me të gjitha të mirat dhe jeta ime u ndryshua totalisht shpejt.

### Po adoleshenca? Ç'mban mend nga ajo kohë?

- Mbjaj mend mjaft momente nga kjo periudhë e artë e jetës sime. Sepse, duke jetuar në një vend turistik, pata mundësi të provoj disa sporte, duke filluar nga skijimi, basketbolli, volejboli, futboli etj. Shkolla ishte e vogël dhe ishim si një familje.

### Puna më e veçantë që ke bërë në jetë?

- Të gjitha punët që i kam bërë në jetë kanë qenë të veçanta dhe më kanë mësuar shumë. Kam përfituar përvoja tejet të çmueshme. Pra, nuk mund ta dalloj ndonjërin si më speciale, më të veçantë.

### Merreni edhe me foto, keni punuar edhe model. Ç'thua për këto?

- I kam dy shokë fotografë. Kam mjaft foto, të cilat, në fakt, i kam bërë vetëm për "Instagram". Mirëpo, sapo i publikova fotot, më ftoi një butik i qytetit tim



dhe ma mundësoi të poztoj për "Dsquared2" dhe "Moncler". I falënderoj fotografët Ibrahim Kodtaliun dhe Nirography.

### Vishesh me stil. Cilat janë markat e preferuara?

- Më pëlqen të vishem bukur, të ndjek trendët e fundit të modës. Markat e mija të preferuara janë: "Adidas", "Dsquared2", "Hugo Boss" dhe "Tommy Hilfiger".

### Je edhe organizator eventesh e koncertesh. Si po të ecë puna në këtë drejtim?

- Pasi diskotekat e njohura janë më larg se 1 orë e 30 minuta nga vendi ku unë jetoj, e të rinjtë duhet të bëjnë tri orë rrugë për të shkuar e për t'u kthyer për një mbrëmje, për t'i parë e dëgjuar yjet shqiptarë, atëherë më lindi ideja që të bëja diçka, që edhe në vendin tonë të sjellim zërat dhe personalitetet e njohura të muzikës. Aksidentet, vështirësitë e rrugës, koha e humbur, më motivuan në realizimin e kësaj ideje. Kështu, rinia shqiptare që jeton në Chur, më s'ka nevojë të udhëtojë me kilometra, kur ndejat më të mira i kanë fare pranë. Mbrëmjet muzikore organizohen në një ambient perfekt në "Bad Ragaz", në Grand Resort në Chur.

### Aktualisht me çka merresh?

- Për momentin gjithë energjinë time po e shpenzoj në një event të madh dhe shumë të veçantë që quhet "Gala of the Eagle". Mbrëmja do të mbahet në hotelin dhe resortin me 5 yje, të quajtur "Bad Ragaz Grand Resort". Yjet e vërtetë të muzikës shqiptare do të jenë në Zvicër, në këtë resort, më 15.10.2021 dhe besoj se do të jetë një mbrëmje gala e paharruar.

### Pos punës, ke ndonjë hobi?

- Po. Hobi im janë fotografia, librat, por edhe arti surreal.

### E, jeta jote private?

- Është private. Nuk dua të flas për këtë temë.

### Për fund, diçka që ka mbetur pa u thënë?

- Çdo ditë e kam një mendim, e që është edhe dëshirë. Ne, shqiptarët, kemi inate, andaj duhet t'i largojmë njëherë e përgjithmonë. Duhet të bashkëpunojmë ndërmjet veti dhe të ecim përpara. Jemi tejet të veçantë, inteligjent, të talentuar, të fortë, por kemi shumë inate... Sidoqoftë, jam krenar që jam shqiptar!

**Nderim Neziri**

# Si të dobësoheni si Capital T, Big Mama, Gili, Anxhela?

## ANXHELA PERISTERI

Prej kohësh këngëtarja Anxhela Peristeri ka vendosur të bie në peshë. Ajo nëpërmjet postimeve të ndryshme në "Instagram", por edhe në paraqitje të ndryshme, ka treguar se ka filluar të frekuentojë palestrën rregullisht dhe ka humbur më shumë se 12 kilogramë.

Këngëtarja ka rrëfyer se kur bën palestër ndihet e lumtur dhe energjike.



## GILI

Gili zbuloi për publikun se kishte humbur 27 kilogramë në 4 muaj, duke rikthyer linjat perfekte trupore. Një ndryshim shumë drastik ky që e ka arritur nëpërmjet dietës së quajtur "Paleo Diet". Me këtë dietë njerëzit hanë ushqime të ngjashme me ato të kohës së paleolitit: peshk, mish, perime, arra dhe fara.





## CAPITAL T

E mbani mend reperin Capital T në fillim të karrierës së tij? Ka qenë i trashë. Mirëpo, viteve të fundit është kthyer në një ndër meshkujt me trupin më të mirë.

Në foto të ndryshme, reperi ka treguar rezultatet e palestrës. Ai ka treguar shpesh në postimet e tij se kujdeset shumë për ushqimin që ha.




## ARIAN ÇANI

Një nga personazhet që habiti publikun me ndryshimin e tij, është edhe moderatori i emisionit “Zonë e lirë”, Arian Çani, i cili ra shumë në peshë. Në një intervistë, ai rrëfeu publikisht se për të arritur peshën ideale nuk ndoqi asnjë dietë të rreptë.

E vetmja gjë që ka bërë Çani është se hoqi dorë prej ushqimit të tepëruar e ëmbëlsirave dhe u mor me vrapim, sport.

Gjithashtu, eliminoi alkoolin dhe ushqimin në orët e vona.



## BIG MAMA

Këngëtarja Big Mama vite më parë i habiti me transformimin në trup. Në fillimet e saj Bigu ka treguar se mbante dietë, mirëpo nuk rezultoi e suksesshme dhe për këtë arsye kreu një ndërhyrje gastrike, e cila ia riktheu format perfekte trupore.

**N. Neziri**



# 10 të famshmit që duhet t'i ndiqni në Snapchat

*Edhe të famshmit janë pjesë e Snapchat-it. Ky rrjet filloi në vitin 2011 dhe që nga atëherë është rritur në një normë befasuese.*

Snapchat krenohet tani me më shumë se 100 milionë përdorues aktiv të përditshëm në këtë rrjet social dhe më shumë se 8 miliardë shikime në ditë.

Nuk është çudi se shumë yje, duke përfshirë Kim Kardashian dhe Chris Pat janë aktiv.

Në "Boom" sjellim adresat e 10 VIP-ave që e vlen të ndiqen në Snapchat...

Arnold Schwarzenegger: arnold-schnitzel  
Bella Hadid: babybels777  
Blake Lively: LivelyBK

Carly Rae Jepsen: craejepsen  
Chance the Rapper: TheAcidRapper  
Chrissy Teigen: chrissyteigen  
Demi Lovato: theddlovatoDiplo: diplo3000  
Harry Styles: h.estyles  
Lady Gaga: ladygaga  
Selena Gomez: selenagomez





**Mandarine Restaurant by Marina Bay**  
+35533410000  
+355696041000

**Lime Lounge by Marina Bay**  
+355696041001  
info@marinabay.al  
www.marinabay.al

**Adresa:** Vlorë, Shqipëri

  
 Marina Bay Cuzco  
 ★★★★★

*Exclusive Promotion*  
 OCTOBER 31, 2021

**WIN THE BRAND NEW JAGUAR E-PACE**

VALUE OF THE CAR 60.000 EURO


**MENTRIN MOTORS**

Nga një kënd ndryshe

# Cilët këngëtarë tanë kanë tekste skandaloze?

*Tekstet e këngëve tona, pa dallim zhanri, kanë mesazhe të shumta seksiste. Qoftë në këngët rep, hip-hop apo ato të folklorit, femrat shpesh përshkruhen me terma pezhorativ, kurse marrëdhëniet burrë e grua në relacione të varshmërisë e nënshtrimit të grave ndaj burrave. Tekste të papërshtatshme në këngët e këngëtarëve tanë ka me bollëk, posaçërisht në këngët rep.*



## GJIKO

Konkretisht, në këngën "Anna", reperi Gjiko i portretizon femrat si të dhëna pas botës materiale: "Sa herë Ana ka kajt, ai i ka blerë një çantë.

Baby, ça ke? Mos e the derën e re  
Mos e gjuj telefonin se prapë duna me ta ble

Jena bo si serial porque, me na ndijn komshinjtë tu u rreh".



Majku



Mozzik



Don Xhoni



## GETINJO

Getinjo është këngëtar shumë i famshëm, por ka tekste diskutabile nga pikëpamja gjinore.

"Lavire" është njëra ndër këngët skandaloze të Getinjos. Në të përshkruhet refuzimi që ish-e dashura i bën, së cilës, për shkak të refuzimit, reperi e cilëson si lavire.

"Kur e din qe t'duaa, pse po bohesh lavire...  
Kallxoma ni arsyë, oh pse po bohesh lavire".

## MOZZIKU, MAJKU, DON XHONI

Edhe tekstet e Mozzikut, Majkut, Don Xhonit e të tjerë, kanë shpesh herë konotacione seksiste e përshkrime të papranueshme për femrat. Madje, ky i fundit, në këngën "Kokaina", e quan "lavire" vajzën që i këndon.





Sabri Fejzullahu



Sinan Vllasaliu

## SINAN VLLASALIU

Sinan Vllasaliu në këngën "Mos ja falni", përçon mesazhe seksiste, arkaike e patri-arkale të poshtërit të gruas që ndahet nga burri, duke e përzënë nga shtëpia dhe ndarë nga fëmijët.

"Kur të del ajo prej shpis,  
largoni gjitha gjanat  
Mos leni asnjë kujtim  
kalljani krejt fustanat  
Dhe hallallin kur kërkon  
mos ja falni mos ja falni  
Veç fëmijë kur përqafo  
mos ja ndalini, mos ja ndalini".

Të tilla tekste problematike, në relacion me gratë, kanë edhe këngëtarët Sabri Fejzullahu e Adelina Ismajli me këngën "Kallma cigaren", pastaj Shyhrete Behluli, Shkurte Fejza e këngëtarë të tjerë të muzikës popullore.



Shkurte Fejza



Shyhrete Behluli



Çifti para gjykatësit

## "Po ta kisha prit burrin fëmijë nuk do të kisha lindur!"

Një çift vendosën të divorcoheshin. Shkuan te gjykatësi. I treguan se nuk mund të jetonin më bashkë dhe kishin vendosur të ndaheshin definitivisht.

Gjykatësi hasi në vështirësi kur erdhi radha të ndarja e fëmijëve. Si t'i ndajë 5 fëmijë?!

Ndërkohë, ai u tha:

"Shkoni në shtëpi, jetoni edhe një vit bashkë. Gjatë kësaj kohe e bëni edhe një fëmijë dhe, pastaj, 6 fëmijë do e kem më lehtë t'ua ndajë tre nga tre.

Gruaja shpejt ia ktheu:

"Siiii?! Po ta kisha prit burrin, as këta 5 nuk do t'i kisha lindur!"

# Gruaja nuk dëshiron divorc, dashnorja nuk po më hiqet!

*Unë dhe gruaja ime, zakonisht, ditën e diel e kalojmë në Gërmë. Një ditë qershori, derisa pinim kafe në Gërmë, nga larg pash një femër të cilën dikur e kam pasur të dashur. Dhe, çuditërisht, erdhi dhe u ul në tavolinën afër nesh. Më pas, pasi kamerieri i tha se çka dëshironte të pinte, ajo ktheu kokën kah unë dhe ma bëri me shenjë se në mbrëmje do më thërriste në telefon.*

## KUR E PASHË NË GËRMË – M'I NDEZI NDJENJAT

Me shenjë që ma bëri se në mbrëmje do më thërriste në telefon, unë mendova se ajo vetëm do më provokonte dhe hiç më shumë.

Edhe unë i dhashë shenjë se do e thërrisja, meqë numrin e saj, edhe pse kishin kaluar vite e vite, ende e dija përmendësh.

Pasi pimë kafe, unë e gruaja u ngritëm dhe u nisëm për në shtëpi. Rugës mendoja se si do ia bëja në mbrëmje, si të gjeja mundësi ta thërrisja në telefon.

Dhe, deshi fati e ajo e hapi temën vetë. Më tha se dëshiron ta bëj një dush dhe kah mbrëmja do shkojë te nëna e saj, meqë kishte kohë që nuk kishte qenë.

"Asnjëherë nuk të kam bërë pengesë që të shkosh te nëna jote, andaj nuk të pengoj as sot", i thashë, duke e përmbajtur veten, që të mos hetonte gëzimin tim që më erdhi aty për aty.

Pasi ajo doli nga shtëpia, shpejt e shpejt e mbylla derën dhe mezi prisja ta thërrisja

Valen në telefon. I thashë se pas një ore do të jem në restorantin tonë të dikurshëm dhe e pres me pa durim.

"Më fal, por nuk mund të vij, sepse sapo më erdhi burri!", më tha.

"Bëja disi dhe eja!", ia ktheva.

"Po, me kusht që të dalim diku jashtë Prishtinës, ku nuk na njeh njeri!", më tha.

## SI E KISHTE PËRGATITUR PLANIN ISH-E DASHURA?

Prita gati një orë afër restorantit tonë të dikurshëm derisa ajo erdhi. Gjatë pritjes në veturë më dukej vetja si një adoleshent, që nuk di ta vlerësojë mirë realitetin.

Kur erdhi, hyri në veturë afër meje dhe menjëherë dorën ia vura mbi këmbë.

Ajo ishte e vetëdijshme për përndezjen time dhe sikur donte që aty për aty të më hidhej sipëri, pavarësisht se a do na shihte kush a jo...

Pas disa kilometrave rrugë, në dalje të Sllatinës, në anën e djathtë të rrugës, ishin do pisha dhe një rrugicë. E ktheva timonin

kah rrugica dhe u ndala skaj pishave. Valja menjëherë m'u hodh sipëri...

As vetë nuk e di sa ka zgjatur ajo gjen-dje, por di se dikur u lodha dhe më nuk mundja as ta puthja...

Kur e lash para banesës së saj, ma shtrëngoi dorën fort. U ndava nga ajo i lodhur fizikisht dhe kam rënë për të fjetur menjëherë, si i vdekur...

Por, nga ajo ditë, më nuk kisha rahat në shpirtin tim. Valja më sillej vërdallë nëpër kokë dhe frikësohesha se shqetësimi timin një ditë do e kuptojë gruaja ime, e cila nuk e meriton tradhtinë time...

Dhe, ashtu edhe ndodhi. Valja e kishte planifikuar mirë atë takim dhe kishte incizuar puthjet tona në celular. Incizimin ia kishte dërguar sime shoqe.

E, që nga ajo ditë, kur gruaja ime ma dërgoi nga telefoni i saj video-incizimin, më nuk flemë bashkë, por në dhoma të ndara...

Dhe, deri kur do të ndodhë kështu, një zot e di...

**B. Teveçeli**



# remos®



Aachener Straße 21 | Köln  
Ulmenstraße 30 | Frankfurt  
Westerwaldpark 4 | WW  
Bahnhofplatz 5 | Koblenz  
[remos-restaurants.de](https://remos-restaurants.de)



[remos\\_restaurants](https://www.instagram.com/remos_restaurants)

# Zenel Baca, nga Lismiri, fle me gjarpinjtë në gji!

*(Këtë bisedë me Zenel Bacën, nga Lismiri i Fushë-Kosovës, me profesion drejtues i lokomotivës, e bëmë në vitin 2004 dhe ia vlen ta përsërisim shkaku i një realiteti shumë të rrallë, sidomos te ne, shqiptarët).*



Edhe pse 80-vjeçar, Zenel Baca (Baci) nuk mund ta mendojë jetën pa gjarpinjtë. Mbi trupin e tij, qëkur ishte foshnjë trejavësh, kanë fjetur gjarpinjtë. Lidhja e tij me gjarpinjtë kalon nëpër lutjen e tij që e di vetëm ai. Misterin e kësaj lidhje Zenel Baca e ka vetëm për vete...

Të gjithë ata që e njohin, mendojnë se plaku 80-vjeçar, Zenel Baca, i lindur në vitin 1924, brenda vetes fsheh energji të panjohura, ndaj të cilave reagojnë në mënyrë paqësore gjarpinjtë.

Ai një jetë të tërë e kaloi në shoqërim me gjarpinjtë dhe bolla, duke i zënë dhe kapur, duke i puthur e duke folur me ta.

Sikur pas amvisës që shkojnë pulat dhe zogjtë, pas Zenelit shkojnë gjarpinjtë. Ai e quan veten kujdestar të tyre dhe për këtë thotë se Zoti e ka krijuar.

E kanë ndjekur gjarpinjtë që nga mosha 3 javësh, në fshatin Lismir të Fushë-Kosovës dhe ky shoqërim e ka përcjellë gjithë jetën, madje edhe në moshë të shtyrë u shërben qenies së

trishtueshme të mbi 99 për qind të njerëzve.

Njeriu me një histori të posaçme të miqësisë me gjarpinjtë, Zeneli, aktualisht me shtëpi në Fushë-Kosovë, fle me gjarpinjtë, loz me ta, flet me ta dhe ata e duan.

Për plakun Zenel nuk ka gjarpër që nuk përvetësohet. Ai e ka kapur me duar edhe bollën katër metra të gjatë në mënyrë paqësore.

## GIJARPINJTË E NDJEKIN PAS...

Zenel Bacën e kanë ndjekur gjarpinjtë qëkur ishte vetëm 3 javësh. Gjarpinjtë kanë fjetur mbi trupin e tij...

Nënë Xhemilja i ka thënë Zenelit se ka pasur një marrëdhënie të veçantë me gjarpinjtë si fëmijë dhe shumë herë është tmerruar nga skenat e trishtueshme, duke mos pasur guxim të prejë të birin, sepse gjithmonë e shoqëronte gjarpri.

“Çka të them, është punë e natyrës të merresh me gjarpinjtë”, thotë Zeneli, në shtëpinë e tij në Fushë-Kosovë, duke

drejtuar gishtin kah jastëku, ku i mban ata gjatë kohës së gjumit dhe shton: “Prindërit më kishin marrë në ara, në Lismir. Më kishin lënë në djep, në një hije peme, teksa korrnin grurin. Kur nëna kishte ardhur të shihte nëse po flija apo isha zgjuar, ishte tmerruar kur kishte parë se mbi trupin tim ndodheshin tre gjarpinjtë.

Nëna, e tronditur, kishte bërë titur me zë të lartë. Dhe, babai, nga trishtimi i zërit, kishte arritur shumë shpejt për të parë se çka kishte ndodhur. “Meqë nuk e kanë thumbuar deri më tash, nuk do e thumbojnë më!”, i kishte thënë babai”, tregon Zenel Baca, duke shpjeguar fëmijërinë, shoqëruar nga gjarpinjtë e shumtë, që e rrethonin kudo që ndodhej.

## SI E QITI BOLLËN MBI QAFË?

Rasti që më së miri mban mend Zenel Baca, sa i përket shoqërimit me gjarpinjtë, është takimi i çuditshëm me bollën në Vërshac, ku ndodhej në shërbim ushtarak, më 1947.



“Kam qenë shofer i tankut. U nisa t’i vë shenjat e gjuajtjes. Në atë pjesë kishte vreshta me rrush. Dhe, derisa po ecja nëpër vreshtë, papritmas pash se bari i thatë ndahej në dy pjesë. Ishte një boll e madhe, shumë e gjatë, ndoshta katër metra. “Mbaju Zenel!”, thash në vete. E kam nxjerr thikën nga brezi dhe e kam bërë gati për të reaguuar, nëse bolla më mbështjellë. I kam dal përpara dhe jam ulur këmbëkryq... Bolla ka ardhur pranë meje dhe e ka vënë kokën mbi prehrin tim. Trupin e ka ofruar afër. Kam filluar ta ledhatoj në kokë. Atëherë është ofruar edhe më shumë dhe në një moment e kam puthur në kokë. Pastaj, e kam vënë mbi qafë dhe jam nisur drejt ushtarëve. Kur më panë iknin nga unë. U krijua një cirk i vërtetë... Në ato çaste ka ardhur oficeri. Dhe, kur ma pa bollën në qafë, më urdhëroi ta dërgoja aty ku e kisha marrë...”, tregon Zeneli.

## SI E LA LOKOMOTIVËN NË HEKURUDHË PAS GJARPINJVE?

Ndër rastet interesante është edhe ai i ndaljes së lokomotivës në stacionin e Cerravikut të Klinës, pasi një njeri me kosë në dorë po ikte nga livadhi. Rreth këtij rasti, Zeneli thotë: “Në Cerravik të Klinës, me të arritur në stacion, pash se ikte me kosë në dorë një njeri nga livadhi. “Hej!”, i bërtita. “Mezi shpëtova nga një tubë gjarpinj në livadh!”, ma ktheu. “Ku janë?”, e pyeta. “Atje!”, më tha dhe drejtoi gishtin tregues në drejtim të tyre. Vrapova në livadh. Ishin 32 gjarpinj, tërthor ndërmjet veti. Në raste të tilla ata mbarësohen. Edhe vajzën, Nafijen, 37 vjeçe, e kam mësuar të zë gjarpinj, por ajo i zë në mënyrën e vet. Edhe djalin e madh, Nuhiun, 36 vjeç, e kam mësuar të zë gjarpinj, por edhe ai i zë pak më ndryshe. Dimrit nuk mbaj gjarpër, sepse jam plakur, e ata duan ushqim, bretkosa, minj a insekte, të cilat nuk mund t’i sigurojë. Por, verës nuk rri pa ta”, përfundon rrëfimin “Baca”.

**Safet Krivaça**



# Vajzat i falë Zoti e i merr dreqi!

*Bash kur mendova se gjeta djaloshin e ëndrrave të mia dhe po prekja parajsën me dorë, ndodhi zhgënjimi im më i madh në jetë dhe u binda se ai nuk më kishte dashur kurrë sinqerisht, por thjesht kishte qenë një aventurë, ku kishte shfryrë epshin e tij, duke shfrytëzuar sinqeritetin tim.*

"Jo më kot thonë: Vajzat i falë Zoti e i merr dreqi!", kështu e fillon rrëfimin e vet Filomena, duke përshkruar fatkeqësinë e saj në dashuri.

Pas përfundimit të gjimnazit shumë shoqe të saj filluan studimet.

"Ndonëse dëshira ime ishte që t'u bashkëngjitëm atyre, edhe prindërit e mi nuk refuzuan. Por, më propozuan të studioja diç ku pas kryerjes së studimeve do të punësohesha më lehtë, sepse kanë ardhur kohë të vështira për t'u punësuar.

Kjo preferencë më përgjigjej edhe mua dhe pa një e pa dy u regjistrova në gazetari, meqë mendoja se pas përfundimit të studimeve më lehtë mund të punësohesha në njërin nga portalet tona që janë te ne, madje me shumicë.

Dhe, pas kryerjes së studimeve, me ndihmën e babait u punësova në një portal të rajonit tonë, i cili veç pat filluar të lexohet e komentohet për shkrime të ndryshme.

## "ERDHI" DASHURIA SI PREJ QIELLI!

Prindërit ishin të kënaqur, sepse ato pak para që merrja në punë, ua jepja dhe filloi

të ndryshojë gjendja jonë materiale.

Por, befas në jetën time "erdhi" dashuria si prej qielli... Fillimisht ngurroja, por duke menduar se po më hapen dyert e jetës dhe ai do të jetë djaloshi i ëndrrave të mia, vendosa që të shoqërohem me "Tonin", kështu ia lash nofkën unë, duke i pranuar komplimentet e tij si ndjenja të sinqerta. Pastaj, ai nuk ishte edhe shumë i moshuar dhe kishte jetë të mirë materiale. Tek e fundja, edhe unë duhej të martohesha, andaj, thash me vete, pse ta humbja rastin... Dhe, në njërin nga ditët që ishim bashkë, e lamë të takoheshim pas orarit të punës. Parkimi i veturës së tij pranë cakut ku ishim marrë vesh nuk më la të hamendeshja shumë. Dhe, pasi shikova anash se më shihte kush a jo, shpejt e shpejt hipa në veturën e tij.

Veturës i dha gaz, ia lëshoi zërin CD-së dhe në një çast, pranë një grope, unë u përplasa mbi krahun e tij. Ai shpejt e shpejt më puthi dhe vazhdoi rrugën...

Në afërsi të një mali, hyri në mesin e shumë lisave të mëdhenj. Desha ta pyesja se çka kërkonte këtu, por goja nuk më punonte. Në ato çaste më shtrëngoi fort për beli, më puthi dhe gjinjtë e mi të paprekur

m'i shtrëngoi fort...

Pastaj, m'i shpërthekoi kopsat e fundit dhe më zhveshi si të ishim në dhomë. Dhe, nuk di çka kemi bërë dhe sa kemi qëndruar aty, sepse isha krejt jashtë vetes...

## KISHA MBETUR SHTATZËNË

Pas asaj dite thujse çdo ditë takoheshim, e pak ditë kishte që nuk bënim seks.

Ndërkohë, fillova të ndjej ca ndryshime në organizmin tim. Dhe, kur ato ia përshkrova një shoqeje, më tha se janë shenja shtatzënie.

Dhe, kur i thashë "Tonit", ai e mori si shaka e jo realitet. Më në fund, më tha: "I gjendet ilaçi edhe kësaj punel!"

"Do të martohemi, a?", i thashë.

"Çfarë martese, bre?! Do të abortosh dhe pikël!", ma ktheu.

Por, nga urrejtja që ndjeva për të në ato çaste, më nuk shkela në pragun e derës së punës. Po ato ditë, me ndihmën e po të njëjtës shoqe, kreu abortin dhe tash sillem poshtë e lart, pa kurrfarë vullneti për jetë...

J. B.





**PARA**

**PAS**



**20 SEANCA**

**-13 KG**

Qendrat e dobësimit 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimit gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht pritet që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksessit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimit tek këto qendra, me rezultate kaq

të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjamt, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimit.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epidermë), duke shpërbë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjik;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimit Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjamt.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjamtin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qullët trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.



Në luftë me vetveten...

# Për mua ke vdekur, por hija jote më ndjekë!

*Ti nuk je më ajo që unë e doja! Ty dikur të shkonin të gjithë fustanet me buzëqeshjet e fytyrës! Tani ti je një tjetër, që shprehë frikë në fytyrë, kurse ajo që unë e doja ka vdekur përgjithmonë...*

I tillë, si jam sot, isha qëkur i mbaj mend lulet dhe fluturat. Gjeja forcë të vrapoja pas tyre derisa i fusja në dorë. Lulet nuk mund të iknin, por fluturat kishin fuqi më të madhe se unë. Aq sa vrapoja për ta provuar fuqinë me fluturat, babai më thoshte mos mendo se janë vetëm

dy krahë të lehtë, sepse aty është fuqia fluturuese.

Kur u rrita sa jam sot, isha ndalur në një stom toke dhe i shikoja lulet nëse kishte flutura. Babai më tha se unë sërish kisha mbetur fëmijë, siç kisha qenë dikur... Më tha se tash dallohem vetëm për nga gjatësia e trupit.

U dëshpërova shumë kur ma dha babai atë vlerësim dhe shpejt u ktheva në odë. Vura kokën mbi jastëkun prej kallëpi të kashtës së fortë, në kërkim të pushimit të mesditës. Desha t'ia merrja inati babait, por mu hodh në kokë si një shkëmb i rëndë tregimi i tij se si ishte rritur jetim dhe thashë se babai nuk e kishte jetuar rininë me prindërit dhe nuk dinte deri në cilën masë mund ta lëndojë fëmijën sikur bëri me mua...

Desha ta falja, sepse nuk kisha çfarë t'i bëja, ai edhe ashtu dukej i lodhur nga jeta e jo nga mosha. Flokun e kishte tamam sikur e mbaja mend në çdo kohë.

E vendosa kokën në jastëk dhe për pak

minuta ndjeva lagështinë në jastëkun prej kallëpi. Shi nuk binte, mendova në atë përgjumje.

Ah, më ranë lotët... E pash veten tek vrapoja një vërrie gurishte të mbushur lule dhe barë. E mbaja për dore dikë që nuk e kisha sot dhe, madje, më erdhi në mendje edhe emri i saj.

Pse t'ia merrja inati babait, kur unë, vërtet, nuk isha rritur?! Ky që jam sot isha edhe para dhjetëra vitesh!

Atë që e kisha ëndërruar me kokë mbi jastëkun e kallëpit, e shihja ëndërr, por nuk di se kush ishte... Nuk di as pse qaja! Por, gjithnjë më dukej se isha penguar t'i përjetoja fluturat dhe lulet sikur dikur... Deudi i vogël, trevjeçar, dilte të ishte me rezonues se unë, kur i thashë se e kisha djalë babanë e tij...

E, ai mu përgjigj:

"Jo, ti nuk ke si ta kesh djalë, sepse ai nuk është i vogël!"

Kishte të drejtë Deudi, sepse mund ta kesh fëmijë dikë vetëm sa është i vogël!



Andaj, ula kokën në jastëk dhe serish e ndjeva lagështinë e jastëkut.

Unë po qaja, sepse isha rritur në botën time të luleve dhe fluturave dhe doja të jetoja ende si fëmijë, vetëm brenda saj. Por, sa herë që ngritja kokën, e shihja babanë duke më ndenjur mbi kokë dhe duke më thënë se je rritur e më nuk je fëmijë, e, në fakt, unë shikoja me bisht të syrit nëse babai më shikonte dhe me t'u larguar sado pak, unë, me sjellje, bëhesha fëmijë si edhe kisha qenë dikur...

Sepse, më pëlqente të isha fëmijë. Unë nuk kisha dashur as të rritesha, apo ndoshta kisha pranuar të isha pak më shumë se fëmijë...

Ti më beson, por ti nuk je këtu pranë meje sonte... Edhe ti je pak si fëmijë. Ndjej si mund ta kallësh botën për një flutur. Ndjej si mund të vdesësh për një dashuri. Ndjej sikur më thua ikim në qiell mbi ndonjë re që ka shi...

Dhe, me kokën mbi jastëkun prej kallëpi dua të të them se ka ardhur vera ime, ka sjell lule dhe kam çka të të dhurojë çdo ditë...

## MË SHUMË LUTEM PËR TY SE PËR VETVETEN!

Ndjej se do të bëja për ty gjithçka... Kisha dal mbi kodër dhe i kisha shtrirë duart në drejtim të erës që m'i valëviste flokët, duke m'i mbyllur sytë fladi.

Lutesha për ty... Por, nuk di edhe çka lutesha... Për ty më kishte zënë mbrëmja duke u lutur.

Mos ikë, qëndro këtu! – fola me zë, teksa jastëku po bëhej gjithnjë e më i lagësht...

Unë mbaja në dorë buqetën e premtuar, që kur të vinte ajo do t'i thosha se është jeta ime.

Por, ajo nuk erdhi. E ndjeva vetëm zërin e saj në valët e telefonit. Sidoqoftë, isha përmallur për zërin e saj.

Më fol diçka të bukur, të lutem! - i thashë.

Dhe, si fëmija që do të del sa më shpejt te dëshira e tij, i thashë se jam duke e pritur që të vjen e t'i merr lulet. I kam bërë buqetë dhe i kam lidhur shumë, që të mos ndahet asnjëra prej tubës...

Por, ajo qante... E, unë, sërish, e ftoja ta merrte buqetën e luleve...

Sa fëmijë që je! - më tha. - Unë jam tërë vaj e ti më thërret për lule! Unë qaj për ty, fle për ty, zgjohem për ty, por nuk po mund të të prek!

Në këtë çast, ula duart dhe buqeta me lule sikur ra nga qielli në një humnerë të thellë. Më rrëshqiti nga duart sikur të mos kishte qenë kurrë në duart e mia.

Provoj të gjej forcën e shpëtimit. Por, ajo sërish më del para, me ftyrën engjëlllore... Ndalem, i them vetes: Ajo për mua ka vdekur... Është hija që më ndjekë...

**S. Murturi**



# Cila grua ia pret burrit organin gjenital?

Një klerik 57-vjeçar mysliman, me emrin Maulvi Vakil Ahmad, në qytetin indian Muzaffarnagar, i kishte dy gra dhe donte të merrte edhe të tretën.

Por, njëra nga dy gratë e tij, Hazra, në shenjë pakënaqësie, ia pret organin gjenital.

Gruaja e dytë e sulmoi burrin, pasi ai ishte këmbëngulës se do merrte edhe gruan e tretë.

Kështu, derisa kleriku ishte në gjumë, Hazra mori një thikë kuzhine dhe i preu organin gjenital burrit, i cili më pas vdes.

## Cili njeri ka këmbën më të gjatë në Kosovë?

Shkëlqim Bajrami, 22 vjeçar, nga Prishtina, është njëri ndër djemtë më të gjatë në Kosovë. Ai është i gjatë 2 metra e 14 cm.

Ai tregon se nga kalimtarët në rrugë shpesh merr komente qesharake, që ia bëjnë njerëzit shkaku i gjatësisë së tij.

Sidoqoftë, Shkëlqimi që katër vjet jeton në Nju-Jork të SHBA-ve dhe merret me basketboll. Ai, ndër të tjerash, tregon edhe për vështirësitë që hasë për të blerë patika, shkaku i numrit të madh të këmbës.



*Jeta private e VIP-ave tanë*

# ***Cilët VIP-a shqiptarë sollën në jetë fëmijë gjatë kësaj vere?***



## **ELITA RUDI DHE GJIKO**

Moderatorja bukuroshe nga Kosova, Elita Rudi dhe reperi Gjiko, janë bërë prindër për herë të dytë gjatë vitit të sivjetmë, duke sjell në jetë vogëlushen e tyre, Bota. Ata para Botës kanë djalë 2-vjeçar me emrin Zëri. Sidoqoftë, Elita dhe Gjiko zgjedhin për fëmijët e tyre emra të veçantë...

## **ARBENITA DHE FERRO**

Pas shumë vitesh në lidhje dashurie, modelja e njohur shqiptare Arbenita dhe reperi Ferro, janë bërë prindër për herë të parë në prill të këtij viti, duke sjell në jetë vogëlushen me emrin Nina.



## **ORINDA HUTA DHE TURJAN HYSKO**

Një muaj më parë, prindër për herë të parë, duke sjell në jetë vajzën e tyre, Atara, janë bërë Orinda Huta dhe Turjan Hysko. "Nuk gjej dot fjalë për të përshkruar gjithë dashurinë që kam brenda vetes për ty. ATARA jonë, kurorë e bekuar e dashurisë sonë 14-vjeçare", thotë moderatorja e njohur, Orinda Huta.



## **ELIONA PITARKA**

Aktorja bukuroshe, Eliona Pitarka, është bërë, gjithashtu, nënë për herë të parë dhe ka sjell në jetë vajzën me emrin Gala. "E dashur bijë, nëse do mund të të jepja një dhuratë në jetë, kjo do të ishte aftësia për të parë veten tënde me sytë e mi", thotë ajo.





**DENTFIX**  
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE

# Te mulliri shejtanët bëjnë dasmë!

*Një djalë u zhduk, të tjerë dëgjonin zëra të çuditshëm në mal. Banorët e këtij fshati besojnë se kishte shejtanë te “Mulliri i Xhindeve”...*



Fshati Pleshinë tash

Pleshina e Komunës së Ferizajt është një vend i bukur, me një panoramë që të kënaqë shpirtin. Malet e gjelbëruara dhe drunjtë që mezi vërehen nga lartësia, të bëjnë të ndihesh mirë, duke të shtuar dëshirën për eksplorim. Por, ç’thuhet për historinë e ujëvarës te “Mulliri i xhindeve”, një emër i

çuditshëm dhe, njëkohësisht, edhe frikësues? Besnik Reka, banor i fshatit, me një rast, ka rrëfyer historinë se si banorët kur kanë dalë për të ecur nëpër mal, te “Mulliri i xhindeve” kanë dëgjuar muzikë dasmash e zëra të shumtë... Por, përveç kësaj, ai tregon se një djalë, i moshës së re, i cili kishte dalë për t’i

ruajtur delet me axhën e tij, ishte zhdukur dhe nuk ishte gjetur më kurrë. Sipas gojëdhënave, nëpër vrimat e krijuara thuhej se qëndronte diçka... Megjithatë, duke lënë anash këtë histori, në ditët e sotme banorët dhe turistët e vizitojnë këtë vend të mrekullueshëm për të përjetuar të njëjtin emocion, që të jep ujëvara.





# Pse e premtja e datës 13 është pa fat?

*Kur bëhet fjalë për “fatin e keq”, ka disa besëtytni të përhapura në kulturën perëndimore, si ajo e së “premtës 13”.*

Ashtu si ndajmë rrugën me një mace të zezë dhe thyerja e pasqyrës, nocioni një ditë që mund të sjellë fatkeqësi është ngulitur thellë në kokë, edhe nëse besimtarët nuk mund ta shpjegojnë plotësisht arsyen. Shtrohet pyetja: Pse kemi frikë nga e premtja e datës 13?

Derisa e premtja e datës 13 mund të duket si një fenomen i rrallë, kalendari Gregorian do të thotë se data 13 e çdo muaji ka pak gjasa të bjerë të premtën, sesa çdo ditë tjetër të javës.

Sidoqoftë, nuk është një besëtytni universale: Në Greqi dhe në vendet ku flitet spanjisht, e marta e datës 13 konsiderohet ditë me fat të keq,

derisa në Itali është e premtja e datës 17 që haset me frikë.

## KU E KA ORIGJINËN E PREMTJA E DATËS 13?

Ashtu si shumë besëtytni që kanë evoluar me kalimin e kohës dhe nëpër kultura, është vështirë të përcaktohet origjina e saktë e së premtës me datë 13. Megjithatë, ajo që dimë është se edhe e premtja, e edhe numri 13, janë konsideruar si të pafat në kultura të caktuara gjatë historisë.

Në librin “Origjina e jashtëzakonshme e gjërave të përditshme”, Çarls Panati gjurmon konceptin e të mallkuarve në mitologjinë nordike, kur Loki, perëndia e ligësisë, përplasi një banket në Valhalla, duke e çuar numrin e perëndive të pranishëm në 13.

I mashtruar nga Loki, perëndia i verbër Hodr u mashtrua për të qëlluar vëllanë e tij Balder, perëndinë e dritës, gëzimit dhe mirësisë, me një shigjetë me majë veshtull, duke e vrarë në çast. Nga Skandinavia, shpjegon Panati,

besëtytnia u përhap në jug, në të gjithë Evropën, duke u vendosur mirë përgjatë Mesdheut me fillimin e epokës së krishterë. Fuqia shqetësuese e numrave u vulosë përmes historisë së Darkës së Fundit, e cila u ndoq nga Jezu Krishti dhe dishepujt e tij të enjten e Madhe. Mysafiri i 13-të dhe më famëkeq që mbërriti, Juda Iskarioti, ishte dishepulli që tradhtoi Jezusin, duke çuar në kryqëzimin e tij të Premten e Madhe. Në traditën biblike, koncepti i të premtëve pa fat, shtrihet edhe më tej sesa kryqëzimi: E premtja thuhet se është dita kur Adami dhe Eva hëngrën frutin e ndaluar nga Pema e Diturisë; ditën kur Kaini vrau vëllanë e tij, Abelin; ditën kur u rrëzua Tempulli i Solomonit; dhe ditën kur arka e Noes lundroi në Përmbytjen e Madhe. Sidoqoftë, vetëm në shekullin XIX, e premtja me datë 13 u bë sinonim i fatkeqësisë: Siç shpjegon Steve Roud te “Udhëzuesi i Pinguinit për Besëtytnitë e Britanisë dhe Irlandës”, kombinimi i së premtës dhe numrit 13 është një shpikje viktoriane.

## MAGJISTARJA

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depressive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

**kontaktoni në këtë email adresë:**

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)

### Lidhja me shokun e burrit

Përshëndetje zonja magjistare, jam grua, 43-vjeçare. Jetoj me brenga, pasi ka vite që jam në lidhje me shokun e burrit. Janë shokë të mirë ndërmjet veti, por brenga ime është se çka do të ndodhë në të ardhmen... Unë nuk mundem pa të, e edhe ai thotë se nuk mundet pa mua.

Çka do të ndodhë me ne?

**"Ëndrra"**

### Përgjigje:

Të heqësh dorë nga kjo lidhje është obligative. Derisa burri yt e shoku i tij më i ngushtë ende ndajnë dhe reflektojnë miqësi, ti në mes tyre je si kancer.

Nuk do mend se do të zbulohet lidhja juaj. Shoh që në muajin nëntor a dhjetor lidhja juaj do të zbulohet. Dhe, kur kjo të ndodhë, nuk do të jetë i madh vetëm zhgënjimi, por edhe pasoja.

Për momentin, në këtë miqësi vetëm burri yt është viktimë, sepse ju po veproni pas shpine, duke e tradhtuar.

Këshilla ime është t'i kthehesh jetës bashkëshortore dhe të heqësh dorë prej tij! Kjo edhe ashtu do të ndodhë, por mos e pritë ditën e fundit që të ndahesh.

### Pse po legalizohet përdorimi i drogave të lehta?

Përshëndetje zonja magjistare, u shkruaj nga Gjakova. Jam një nënë që lexoj shumë.

Kohëve të fundit shumë shtete po e legalizojnë përdorimin e disa drogave.

Pse po ndodhë kjo?

**"Nëna gjakovare"**

### Përgjigje:

Shekulli XXI është etapa e përdorimit më të madh të substancave të ndaluara që marrin shëndetin dhe mendjen e njeriut, e më së shumti të brezit të ri, në të cilin mbetet e ardhmja e njerëzimit.

Por, rreziqet nga ky përdorim janë aq të mëdha sa nuk llogariten...

Ne e dimë se disa shtete prodhojnë edhe atom dhe nga ai atom një pjesë e botës mund të zhduket me një përdorim të tij...

Andaj, duke u lidhur direkt me pyetjen tuaj për përdorimin e drogës, del se sot përdoruesit janë aq të shumtë, sa në disa shtete ekspertët kanë parë se më mirë është të lejohet përdorimi i kontrolluar, sesa përdorimi i egër i këtyre substancave. Sepse, përdorimi i substancave të ndaluara nuk mund të kontrollohet në tërësi askund.

Por, çka do të ndodhë pas gjysmë shekulli, shtrohet pyetja...

### Çka po ndodhë me burrin tim? Pse më bërtet për çdo gjë?!

Përshëndetje, jam grua që jetoj në Zvicër. Jam mbi 50 vjeçe, kam probleme me burrë. Nuk di ku e kanë bazën këto probleme. Nuk kam guxim t'i bëj asnjë pyetje, nuk kam guxim as ta shikoj...

Ka kohë që nuk më do dhe shoh se më urren shumë, sa nuk do as ta shikoj me sy! Fëmija janë rritur, jetojnë në banesat e veta. Me të më nuk shoh se ka bashkëjetesë. Të lutem, mos i shëno emrat...

Çka sheh ti në rastin tonë?

**"Pa shifër"**

### Përgjigje:

Ju keni probleme të vjetra. Të pak-tën, keni probleme që 10 vjet dhe ato lidhen me ty, pikërisht. Kanë të bëjnë me një person ku ke punuar...

Ti ke pasur probleme me të, por e keni ruajtur familjen shkaku i fëmijëve.

Tani je në kohë menopauze dhe durim ke shumë pak. Lodhja psikike e ka humbur durimin, kurse lodhja fizike veç ka filluar, ndërkaq zemra ka mbetur po me ato probleme që ke pasur dikur...

Ka mundësi të ndaheni. Të preferoj të bisedosh me fëmijë që të jetosh me ta, në mënyrë që burrit t'i kalojë tensionimi, sepse mund të prodhohen situata të rrezikshme...

Prandaj, është momenti më i duhur që ta menaxhoni veten. Por, nëse ai nuk ka mundësi, atëherë ti menaxhoje veten, duke ikur nga konflikti. Sepse, po që se njëri prej jush mund t'i shmangët konfliktit, ai e minimizon një fatkeqësi që sjellë pasoja.

### A do të mund të jem pranë fëmijëve të mi?

Zonja magjistare, u përshëndes shumë! Jam grua, 30- vjeçare, jetoj me dy fëmijët e mi jashtë Kosovës.



Kam probleme, të cilat e kam zor me i nxjerr në sipërfaqe, meqë lidhen me burrin dhe vajzën e axhës...

Prandaj, po të shkruaj t'më hapësh rrugë për një zgjidhje... Konkretisht, vajza e axhës u lidhë në një farë mënyre me burrin tim. Unë kisha dyshime, por i pash vetë...

Nëse i tregoj burrit, me siguri, do më braktisë, sepse edhe ashtu më ka thënë që mund të ndahemi. Në anën tjetër, nëse e bëj të madhe, preku në familjen time! Çka të bëj, si ta zgjidhi këtë problem?

**"Në udhëkryq"**

## Përgjigje:

*Unë shoh se, nëse ti e bën të madhe, nuk do të të besojë askush... Dhe, jo vetëm që nuk do e pranojnë se janë në lidhje, por ti do të mbe-tesh fajtores!*

*Këtë temë ka logjikë ta hapësh vetëm me vajzën e axhës tënd, duke ia treguar faktet që i ke parë bashkë...*

*Bisedo me vajzën e axhës dhe i thuaj se nuk dëshiron ta bësh të madhe këtë punë, por gjërat i di... Kërko nga ajo që të largohet në heshtje dhe vazhdoni jetën tuaj bashkëshortore.*

*E, një gjë, që duhet ta bëni më vonë, është: Ajo apo ju duhet të largoheni prej të atij vendi, sepse më nuk mund të jetoni si fqinj, meqë situata e tashme mund të përsëritet...*

## Pas mëkateve dua të nisi një jetë të re...

Përsëndetje zonjë e nderuar, jam 21-vjeçare, kam një hall të madh...

Jam shtatzënë, në muajin ku nuk mund të bëhet aborti. Po ndihem keq para familjes sime...

Kjo ka ndodhur si pasojë e

bashkëjetesës me një person që e doja dhe nga ai prisja të shkojë çdo mirë...

I kam zhgënjyer shumë familjen dhe jam e dëshpëruar nga jeta.

Jam e penduar dhe dua që Zoti t'mi fal mëkatet që i kam bërë...

Të lutem, si do të jetë jeta ime në të ardhmen, sepse po më vjen keq edhe prej vetvetes?

**"Fr."**

## Përgjigje:

*Nëse mendon për historinë e këtij problemi, është vonë dhe reagimi i vonuar ka bërë që gjërat të vështirësohen deri tek pendimi.*

*Shtatzënia me njeriun jo të duhur ka krijuar pakënaqësi si te ti ashtu edhe në familjen tënde...*

*Por, fëmija është fëmijë, pa marrë parasysh se kush është babai i tij, i bardhë apo me ngjyrë...*

*Ajo që është me rëndësi në këto çaste është të jesh e qetë dhe të mos kalosh në depresion, sepse do bëhesh nënë dhe do të fillojnë preokupimet e reja si ta rrisësh fëmijën...*

*Andaj, së shpejti jeta jote do të ndryshojë shumë, sepse do bëhesh nënë, do kujdesesh për foshnjën... Megjithatë, do të vijë ditët kur do të qeshesh, do të bësh jetë pas stres, jetë stabile.*

## Nuk po mundem pa të!

Jam një burrë i martuar. Në rini e kam dashur një vajzë, e cila tani është bërë zonjë. Koha ka shkuar, por nuk mund ta harrojë...

**"Pa shifër"**

## Përgjigje:

*Nuk duhet të shkosh pas ëndrrave rinore. Koha ka kaluar dhe nuk është në dobinë tënde të jetosh me ëndrrat e së kaluarës...*

*Ti nuk e ke shfrytëzuar të drejtën tënde për ta lidhur jetën me atë që e ke dashur, prandaj sot nuk ia vlen*

## PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: "Kosovarja", fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

*të shkaktosh probleme për një gjë që nuk u takon më.*

*Shoh se mund të zbulohet problemi, andaj ktheju jetës reale...*

## Kah të shkoj?

Përsëndetje, jam nënë e dy fëmijëve, si drita e Zotit. Deri më tani kam qenë e lumtur me burrë e martesë, por ka kohë që kam një brengë të madhe, sepse po grindemi për imtësi...

Nuk jam mësuar me këtë gjendje, andaj nuk di çka të bëj...

Disi, kam bindjen se ai po fsheh diçka prej meje...

A është kjo fazë e jetës martesore apo diç më shumë?

**"..."**

## Përgjigje:

*Në jetën bashkëshortore është dominante të besoni në njëri-tjetrin dhe jo të krijoni mëdyshje, sepse për të kritikuar duhet pasur bazë, argumente.*

*Nëse ai del natën dhe rri deri vonë; nëse kthehet i dehur në shtëpi e u maltreton; nëse u rrahë e u bën zullum; nëse të mban gatitu para vetes etj.*

*E, nëse këto gjëra nuk ndodhen te ju, por bazoheni se burri nuk u thotë "të dua" si dikur, kjo është një dalje nga shprehja, por jo një moment ku përjash-tohesh ti.*

*Ju keni fëmijë, e ata i marrin brengat tuaja. Janë më të vlefshëm se çdo gjë. Bota është ndër-tuar duke ua kushtuar prindërit jetën fëmijëve dhe në këtë rrugë lidhja bëhet e dorës së dytë...*



# Cila është shenja më “e neveritshme” në Horoskop?

*Nuk bëhet fjalë as për Akrepin dhe as për Luanin, të cilët janë të famshëm për manipulimet e tyre.*

Sipas astrologëve, shenja më “e neveritshme” në Horoskop është Peshorja. Por, pse?

Karakteristikat negative që një Peshorja ka, janë:

\* Peshorja është e pavendosur.

Përpjekja për të gjetur ekuilibrin dhe drejtësinë e bën të vështirë për të edhe në vendime të thjeshta, duke irrituar ata përreth tij. Por, edhe marrja e një vendimi mund të ndryshojë mendjen tuaj.

\* Peshorja “qanë” vazhdimisht.

Mund të mos jetë i famshëm për ndjeshmërinë e tij, por ai mbyllet në mikrokozmosin e emocioneve të tij, duke kërkuar dhembshurinë e të tjerëve.

\* Ju nuk mund të mbështeteni në të.

Është partner i vështirë, sepse nuk mund ta dini nëse ai do të jetë konsistent në një detyrim.

Gjithashtu, nuk e dini nëse ai do të mbajë diçka që ju do t'i besoni atij

ose nëse ai do ta bëjë atë një çështje thashethemesh.

\* Është super-sipërfaqësor. Ai do çdo gjë të bukur dhe materiale, mund të kalojë orë të tëra me pamjen e tij, por ai nuk shikon atë që është nën sipërfaqe.

\* Peshorja sillet sikur gjithçka i përket atij. Është sikur e gjithë bota u detyrohet atyre ekzistencën.

Ai dëshiron gjithçka dhe e dëshiron atë menjëherë!





# SHERWOOD

*Resorts and Hotels*

*Feel the Legend*

**SHERWOOD  
EXCLUSIVE KEMER**  
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD  
EXCLUSIVE LARA**  
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD  
DREAMS RESORT**  
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE  
BELEK**  
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD  
SUITES RESORT**  
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD  
GREENWOOD RESORT**  
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD  
PRIZE HOTEL**  
LARA / ANTALYA

+90 242 444 88 07  
www.sherwoodhotels.com.tr

